Fjalori Shpjegues

Anglisht-Shqip

i

Sistemit Shëndetësor

Përgatitur nga

Dr. Vasil Miho

Përfaqësues i Organizatës Botërore te Shëndetësisë në Shqipëri

Tetor 2002

A

Abortion (Dështim)
Dështimi është një procedurë kirurgjike ose mjekësore për të ndërprerë shtatzaninë, duke larguar fetusin dhe placentën prej uterusit.

Acceptability (Pranueshmëri)
Është niveli se deri ku një shërbim plotëson nevojat kulturore dhe standartet e një bashkësie njerëzish. Ky nivel nga ana e tij do të ndikojë mbi përdorimin e këtij apo atij shërbimi.

Accessibility(access) of health care (Aksesibiliteti, aksesi ne kujdesin shëndetësor)
Një tregues që mat atë pjesë të popullsisë që arrin të sigurojë shërbimet e duhura shëndetësore.
Aksesibiliteti financiar tregon sesa në gjëndje është masa e njerëzve për të paguar për kujdesin shëndetësor. Zakonisht ai mund të matet përmes rezultateve të një studimi mbi gatishmërinë dhe mundësinë e një popullate për të paguar.
Aksesibiliteti gjeografik tregon sesa të shtrirë janë shërbimet shëndetësore në hapësirë.
Sigurisht që kjo lidhet me shpërndarjen e infrastrukturës në një rajon të caktuar, por gjithashtu edhe me sigurimin aktual të këtyre shërbimeve në këto institucione.
Aksesibiliteti gjeografik varet nga mjetet lokale të transportit, si dhe nga topografia lokale.
Aksesibiliteti kulturor tregon nëse aksesi ndaj shërbimeve shëndetësore pengohet nga tabutë kulturore.
Këtu mund të jepen tre shembuj(i) a mund të përdorin gratë shërbimet shëndetësore nëse të gjithë mjekët në institucionin shëndetësor janë meshkuj? (ii) a do të përdorin personat që i përkasin një pakice etnike shërbime ku punojnë njerëz nga shumica e popullsisë? (iii) a do të përdorin njerëzit shërbimet shëndetësore për procese të cilat konsiderohen natyrore, pra që nuk kanë nevojë për ndërhyrje mjekësore (si shtatzania)?

Accountability (Përgjegjshmëri)
Detyrimi për ti bërë publike periodikisht drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi, në detajet e duhura dhe në mënyrë harmonike të gjithë palëve, parimet, qëllimet, procedurat, lidhjet, rezultatet, të ardhurat dhe shpenzimet e çdo veprimtarie apo punë, në mënyrë që ato të mund të vlerësohen nga palët e interesuara.

Accreditation (Akreditim). Shih gjithashtu "Licensing"
Procesi me anë të të cilit një agjensi e autorizuar ose një organizatë tjetër vlerëson dhe njeh një institutucion ose një individ sipas një seri "standartesh" të cilat përshkruajnë strukturat dhe proceset që kontribuojnë në rezultatet e dëshirueshme për pacientin.
Në dallim me liçensimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, i cili zakonisht është i detyrueshëm dhe i imponuar nga qeveria, akreditimi zakonisht është vullnetar dhe kryesisht i administruar nga organizmat jo-qeveritare. Akreditimi ka dy tipare kryesore: parimin e kontrollit të jashtëm dhe përdorimin e standarteve.

Active immunity (Imuniteti aktiv)
Një rezistencë e krijuar si përgjigje ndaj një ngacmimi me antigjen (një agjent infektiv ose një vaksinë) dhe zakonisht e karakterizuar nga prania e antitrupave të prodhuar nga strehuesi.

Acute Respiratory Infections-shkurt ARI (Infeksione akute respiratore)
Infeksione të rrugëve të frymëmarrjes që lidhen më tepër me moshën fëminore pasi shaktojnë një sëmundshmëri dhe një vdekshmëri të lartë. Nga pneumonia në botë ne vitin 2000 vdiqën më tepër fëmije se nga çdo sëmundje tjetër.

Adequacy (Përshtatshmëri, mjaftueshmëri).Shih gjithashtu "Appropriateness"
Zbatimi i atyre masave, teknologjive dhe burimeve të cilat do të ishin të mjaftueshme nga pikëpamja cilësore dhe sasiore për të arritur qëllimin e dëshiruar.
Të qënit i përshtatshëm (adekuat) dhe të qënit siç duhet (appropriate) shpesh përdoren njësoj, megjithëse ka një dallim të lehtë midis tyre. Kur thuhet se një kujdes shëndetësor është i përshtatshëm (adekuat) ka një tendencë që ai të kuptohet si "i mjaftueshëm" gjë që e dallon nga një shërbim "siç duhet"(approriate) që do të thotë më tepër si "pikërisht ai shërbim që nevojitet".

Administration (Administrim). Shih "Management"

Administered prices (Çmime të administruara). Shih "Prices"

Adverse selection (Përzgjedhje e keqe). Në dallim me "Cream skimming"
Një situatë ku individët janë të aftë të blejnë sigurime në ato shkallë përfitimi, të cilat janë poshtë përqindjeve të ndërshme ,pasi informacioni që ata kanë nuk është i disponueshëm nga siguruesit .Informacioni në këtë rast quhet asimetrik.
Përkufizim plotësues: Një proces i cili ndodh kur individe të cilët priten të kenë humbje të ndryshme, paguajnë të njëjtin premium për sigurimet shëndetësore, dhe ku ato që priten të kenë humbje më të vogla dalin nga skema e sigurimeve shëndetësore, duke lënë aty vetëm individë me humbje të pritshme të mëdha.
Përzgjedhja e keqe mund ta bëjë të vështirë ekzistencën e sigurimit privat.

Advocacy: Ngritje e zerit ne mbrojte te diçkaje apo dikujt.

Affordability (Përballueshmëria, mundësia financiare, se sa mund t'ia dalësh financiarisht)
Është shkalla sesa klientët e një shërbimi janë në gjëndje të paguajnë atë shërbim
Kjo do të varet nga shpërndarja e të ardhurave, kostoja e shërbimit dhe mekanizmi financiar (për shembull nëse risqet janë marrë përsipër nga të gjithë, nëse ekzistojnë përjashtime për ata që kanë rrogë të ulët etj).

Age-adjusted mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë e modifikuar sipas moshës)
Një shkallë e vdekshmërisë që modifikohet në mënyrë statistikore për të eleminuar efektet e shpërndarjeve të ndryshme të moshave në popullata të ndryshme.

Agency principle (Parimi i agjensisë)
Procesi i ekzistencës së një palë që quhet agjent e cila merr vendime në emër të një palë tjetër që quhet principali.

Age-specific mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë specifike sipas moshës)
Një shkallë e vdekshmërisë për një grup-moshë të caktuar. Numëruesi është numri i vdekjeve në atë grup moshe ndërsa emëruesi është numri i personave në atë grup moshe.

Agent (Agjent)
Një faktor si për shembull një mikroorganizëm, substancë kimike ose ndonjë formë e rrezatimit, prania , apo prania e tepruar ose mungesa relative e te cilit është thelbësore për shfaqjen e problemeve shëndetësore.

AIDS-Acquired Immunodeficiency Syndrome (Sindromi i Pamjaftueshmërisë Imunitare të Fituar) Një dobësim progresiv i sistemit imunitar i shoqëruar nga një ose me shumë sëmundje indikatore (infeksione oportuniste), përfshirë sarkomën e Kaposit, kancerin invaziv cervical, pneumoninë nga *Pneumocisti carini* dhe sindromin e dobësimit Gjatë AIDS-it, përkeqësimi i sistemit imunitar dallohet nga pakësimi i qelizave ndihmëse T, të cilat ndihmojnë në stimulimin e prodhimit të kundërtrupave. AIDS shkaktohet nga një retrovirus i quajtur HIV

Albanian Red Cross (Kryqi i Kuq Shqiptar)
Themeluar në 1921. Fushat kryesore të ndërhyrjes janë shëndeti,shoqëria, informacioni dhe përhapja e parimeve të lëvizjes botërore të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhënës së Kuqe dhe i të drejtës humanitare ndërkombëtare. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar është themeluar në vitin 1864.

Alcohol dependance (Vartësi nga alkoli)
Një nevojë për doza të përsëritura të alkolit për tu ndjerë mirë ose për të mos u ndjerë keq

Allocative efficiency (Efiçienca alokative). Shih "Efficiency"

Alternative hypothesis (Hipoteza alternative)
Hipoteza që duhet zbatuar kur hipoteza zero rezulton jo e besueshme, në të cilën ekspozimi ka lidhje me sëmundjen.

Alternative medicine (Mjekesi alternative): Një kategori e gjere e sistemeve trajtuese (si për shembull kiropraktika, mjekesia me bime, akupunktura, homeopatia, naturopatia dhe devocioni shpirteror) ose tradita te bazuara ne kulture si shkenca Kineze dhe Kristiane. Karakterstika kryesore e tyre eshte se nuk pranohet nga shkencat biomjeksore. Gjithashtu quhet edhe si mjekesi plotesuese.

Ambulatory care (Kujdesi ambulator). Shih gjithashtu "Outpatient care" dhe "Primary/Secondary/Tertiary health care"
Të gjitha llojet e shërbimeve që i ofrohen pacientit, të cilat nuk e detyrojnë atë të zërë një shtrat institucional si pacient i shtruar, gjatë shërbimit që ai merr.
Kur ky lloj kujdesi shëndetësor jepet edhe në institucione të cilët ofrojnë gjithashtu kujdes për pacientë të shtruar. Ai quhet "kujdesi për pacientë të jashtëm"(outpatient)
Përkufizim plotësues:Shërbimet e kujdesit shëndetësor që ofrohen në shumë mjedise që shtrihen nga zyrat e mjekëve deri tek institucionet e pavaruara ambulatore kirurgjikale dhe qëndrat e kateterizimit kardiak.

Amenities: (Komoditete, Rehatira)
Perfshin cdo perfitim te prekshem dhe jo te prekshem , vecanerisht ato qe e bejne dicka (p.sh spitalin) me terheqes ose i shtojne vlere, apo qe ndihmojne ne rehati apo komoditet .
Per shembull ne nje spital "amenities" jane nje salle komputerash, nje sherbim interneti, nje salle lodrash, nje sherbim postar, nje salle mbremjesh , nje faks, telefon, apo fotokopjatrice, dyqane te ndryshem , nje sherbim postar .Por edhe nje pamje e bukur nga dritarja e nje spitali perfshihet ne kete term.

American Red Cross (Kryqi i Kuq Amerikan)
Ai vepron në Shqipëri që prej 1999 në mbështetje të partnerit të tij shqiptar.Aktivitetet e tij përfshijnë programe në ndihmat ushqimore, edukimin shëndetësor, mobilizimin social, mbështetje teknike për fushatat e fruthit dhe rubeolës etj.

Analytic epidemiology (Epidemiologjia analitike)
Ajo degë e epidemiologjisë që merren me kërkimin e shkaqeve dhe pasojave mbi shëndetin.Ajo përdor grupe krahasimi, të cilët ofrojnë të dhëna bazë për të përcaktuar nga pikëpamja sasiore asocijimin midis ekspozimeve dhe rezultateve si dhe hipoteza mbi lidhjet shkakësore.

Analytic study (Studim analitik)
Një studim krahasues që synon të identifikojë dhe të përcaktojë nga pikëpamja sasiore asocijimet, hipotezat dhe të identifikojë shkaqet. Dy tipe të zakonshme janë studimi kohort dhe ai rast-kontroll.

Antibiotic (Antibiotik)
Një medikament për të trajtuar infeksionet bakteriale. Era e antibiotikëve ka filluar në vitin 1945. Babai i tyre mbahet Aleksandër Fleming

Antigen (Antigjen)
Është një substance e huaj që shkakton një përgjigje imunitare në organizëm (prodhimin e kundërtrupave për të luftuar antigjenët).Shëmbuj të zakonshëm të antigjeneve janë bakteriet dhe viruset që shkaktojnë sëmundje tek njeriu. Kundërtrupi formohet në përgjigje të një antigjeni të specifik, duke mos reaguar me të tjerë
.

Antiretroviral (Antiretroviral)
Një medikament, i cili ndalon ose suprimon veprimtarinë e një retrovirusi si ai i HIV-it. AZT-ja ishte medikamenti i parë antiretroviral që u përdor gjërësisht. Tani në treg po dalin të tjera medikamente edhe të kombinuara. Antiretroviralet nuk është se e kurojnë sëmundjen por ndihmojnë në menaxhimin e AIDS-it si një sëmundje kronike.

Appropriate(ness) (Përshtatshmeri ,të qënët siç duhet)
Flasim për përshtatshmeri ose të qënit siç duhet nëse një përfitim shëndetësor i kapërcen pasojat e pritshme negative në atë masë sa të justifikojë procedurat e kryera

Applied epidemiology (Epidemiologji e aplikuar)
Zbatimi ose praktikimi i epidemiollogjisë për të trajtuar probleme të shëndetit publik.

Appropriate health technology (Teknologjia shëndetësore e përshtatshme)
Metodat, procedurat, teknikat dhe paisjet në fushën e shëndetesisë që janë të bazuara shkencërisht, të përshtatura me nevojat lokale dhe të pranueshme për ata që i përdorin dhe për ata mbi të cilët përdoren dhe që mund të mirëmbahen dhe të shfrytezohen me burimet e komunitetit ose që një vend i caktuar mund ti përballojë financiarisht.

Assessment (Vlerësim)
Grumbullimi i rregullt, analiza dhe shkembimi i informacionit lidhur me kushtet shëndetësore, rreziqet dhe burimet në një komunitet. Procesi i vlerësimit duhet për të bërë identifikimin e tendencave të sëmundjes, aksidenteve dhe vdekjeve, faktoreve të cilët mund ti shkaktojnë ato, burimeve të disponueshme shëndetësore dhe zbatimit të tyre, nevojave të paplotësuara dhe perceptimimin e komunitetit lidhur me çeshtjet shëndetësore.

Association (Asocijim, shoqerim)
Lidhje statistikore midis dy ose me shumë ngjarjeve, karakteristikave ose variableve të tjera.

Asymptomatic (Asimptomatik)
Pa shënja klinike.Përdoret shumë kur flitet për HIV/AIDS, pasi i referohet mungesës së shënjave klinike megjithë praninë e virusit në organizëm.

ATC classification of drugs (Klasifikimi ATC i barnave)
Klasifikim i barnave, i bazuar në kriteret anatomike,terapeutike dhe kimike.

Availability (Disponueshmeria, prania)
Prania e shërbimeve shëndetësore të nevojshme.

Average length of stay (Ditë-qëndrimi mesatar)
Pjesëtimi i numrit total të ditëve të qëndrimit të pacientëve në spital apo në një institucion të shërbimit akut, me numrin e daljeve apo shtrimeve në spital
Nëse dita e pranimit dhe dita e nxjerrjes numërohen si një ditë ose dy, kjo varet sipas vendit.

Attack rate (Shkalla e sulmit)
Një variant i shkallës së incidences, që zbatohet për një popullate të vogel dhe që vëzhgohet për një kohe të kufizuar, si për shembull gjatë një epidemie.

Authorisation of Drugs Manifacturing (Autorizimi për Fabrikimin e Barnave)
Një dokument i lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë çdo subjekti të interesuar për të zhvilluar në Republiken e Shqipërisë veprimtari fabrikuese të barnave apo edhe për operacione fabrikimi të pjesëshme si fraksionim, konfeksionim dhe prezantim të barnave të destinuara për tu shitur në Shqipëri edhe për eksport.

AZT (Retrovir dhe zidovudinë)
Janë emrat e zakonshëm për substancen kimike 3-azidothymidinë. Ka qënë medikamenti i parë në treg për trajtimin e AIDS-it. Mendohej se ai mund të kishte qënë kura për sëmundjet që lidhen me AIDS-in, por shpresat u shuan në Kongresin Ndërkombëtar të AIDS-it në Berlin në 1993. AZT nuk është as i mirë si pretendojnë prodhuesit e saj,por nuk është aq i keq si akuzojnë aktivistët e AIDS-it. Në kombinim me medikamente të tjera (kokteil) ajo mund të ndihmojë në ngadalësimin e përparimit të HIV/AIDS. Ajo patjetër që ndihmon në ndërprerjen e transmetimit perinatal të HIV-it.

B

Baby friendly Hospital (Spital "Mik i foshnjave")
Nisma "Spitalit Mik i Foshnjave" është një program ndërkombëtar i OBSH-së dhe UNICEF-it. Mbështetur në dhjetë hapat e ushqyerjes së sukseshme me gji, iniciativa njeh spitale dhe shtëpi lindjeje të cilat kanë ndërmarrë hapa për të siguruar një mjedis optimal për nxitjen, mbrojtjen dhe mbështetjen e ushqyerjes me gji. Ushqyerja me gji njihet nga një numër jashtezakonisht i madh autoritetesh shëndetësore si themeli i një shëndeti të mirë për foshnjat. Përveç kesaj, ushqyerja me gji ofron mundësi të mira për shëndetin e gruas si dhe për shoqërinë në formën e pakësimit të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor. Që nga krijimi i saj në vitin 1991 kjo nismë ka përfshirë rreth 15.000 spitale dhe shtëpi lindjeje në më tepër se 125 vënde, të cilët kanë marrë çmimin e nderuar "Mik i foshnjave". Edhe në Shqipëri ka dy spitale të tilla, ai i Fierit dhe ai i Lezhës.

Baseline (Linja bazë, niveli bazë)
Një vrojtim apo një vlerë e cila përfaqëson nivelin bazë të një sasie të matshme, pra një lloj pike referimi.Informacioni i linjes së bazës shpesh përdoret për të bere krahasimin me të dhënat e reja, për të përcaktuar përparimin apo prapambetjen.

Basic needs (Nevojat bazë)
Një term i përdorur për mallrat dhe shërbimet bazë të nevojshme për një minimum standart jetese si ushqimi, strehimi, veshja, higjena dhe arsimi,

BCG Bacille Calmette Guérin (Bacili Calmette Guérin)
Vaksinë për të parandaluar tuberkulozin. Jepet në momentin e lindjes.
BCG do të thotë *Bacille Calmette-Guerin* (Bacili i Calmette-Guerin) BCG është një vaksinë për t'u mbrojtur nga tuberkulozi që e ka marë emrin sipas shkencëtareve francezë Calmette dhe Guerin. Vaksina është prodhuar për herë të parë në vitin 1924. Përdoret tek foshnjat dhe femijët në ato vënde ku ndeshet tuberkulozi. Në bazë të saj ka një version të zbutur të *Mycobacterium bovis.*

Bed days (Ditë-shtrat)
Një ditë gjatë së cilës një person qëndron në shtrat dhe ku pacienti kalon një natë në spital.
Ditë shtrat/për frymë ofron një mënyrë të maturi për të krahasuar shfrytëzimin e spitalit,duke marrë në konsideratë shtrimet, daljet dhe ditëqëndrimet.

Bed occupancy (Shfrytëzim shtrati)
Një tregues që shpreh shkallën e përdorimit të një shtrati spitalor nga pacientët.

Benchmarking (Krahasim).Shih gjithashtu "Best practice".
Një proces i matjes së produktit ose shërbimit të një organizatë tjetër sipas standarteve specifike, në mënyrë që ta krahasosh atë me produktin apo shërbimin tënd.
Standartet e specifikuara për krahasim shpesh përfaqësojnë standarte mesatare.
Përkufizim plotësues: Krahasimi është një metode sistematike e përshkruar si " të kërkuarit e praktikes më të mirë që do të çojë në një kryerje pune më të mirë" . Krahasimi mund të bëhet

brenda të njëjtës organizatë (krahasim i brëndshëm),jashtë organizatës me një tjetër organizatë e cila prodhon të njëjtin produkt ose shërbim (krahasim i jashtëm) ose duke iu referuar një funksioni ose procesi të ngjashëm në një fushë tjetër (krahasim funksional)

Beneficiaries (Përfituesit)
Individet e mbuluar nga një plan shëndetësor, pra ata persona që përfitojnë prej këtij plani
Kur themi përfitues mund ti referohemi si planeve shëndetësore publike ashtu dhe atyre private. Shpesh në anglisht në sistemin publik përdoren me të njejtin kuptim termi i siguruar në tre variante "insuree" (person i siguruar, pra si emër),insured (i siguruar pra si mbiemer) dhe "member"(anetar) ndërsa në sistemin privat më tepër përdoren termat "enrollee (i rekrutuar) dhe subscriber (i abonuar).

Benefit (Përfitim). Shih gjithashtu fjalën "Health benefit"
Në sigurimin shëndetësor, mund të jetë qoftë një pagesë me pará në dore që paguhet për të plotësuar një pretendim, në kuadrin e kushteve të një politike të dëmshpërblimit ose sigurimi i shërbimeve në natyre sipas një skeme të sigurimit mjekësor.

Benefits package (Paketa e përfitimeve)
Seria e shërbimeve dhe avantazheve në pará apo natyre, të cilat i gëzon një person, që plotëson disa kritere të caktuara.
Ndonjëherë quhet "katalogu" ose "shporta" e përfitimeve.
Përkufizim plotësues:Në sistemin e sigurimit shëndetësor dhe social, paketa e përfitimeve siguron të drejtën për një seri të shërbimeve të kujdesit shëndetësor për të siguruarit, të cilët përcaktohen sipas kritereve të vendosura në skemë.

Best practice (Praktika më e mirë). Shih gjithashtu "Benchmarking"
Një ekzaminim i metodave me anë të të cilave arrihen rezultatet optimale.
Praktika më e mirë bashkë me krahasimin ,është një koncept organizativ që zbatohet në sektorin industrial dhe që gjithnjë e më tepër lidhet me menaxhimin dhe administrimin. Në këtë kontekst, "praktika më e mirë" i referohet një koncepti që shpreh një proces për të arritur përmirësime brënda agjensive ose mjediseve të veçanta me kalimin e kohes. Përmirësimet karakterizohen nga matja e cilësisë, efektivitetit, kosto-efektivitetit dhe rezultateve prodhuese.

Beveridge system (Sistemi Beverixh). Shih edhe "Sistemi i sigurimit social dhe shërbimeve shëndetësore që e ka origjinën nga raporti i Beverixhit në Angli dhe Uells, i publikuar për herë të parë në vitin 1943. Ky raport rekomandon sigurimin e kujdesit shëndetësor për të gjithë njerëzit përmes sistemit qëndror të taksave dhe kontributeve të tjera financiare të detyrueshme dhe se një sistem i përfitimeve universale duhet të japë mbështetje kur tjetri është i papunë , i sëmure, invalid dhe ka dale në pension. Akti i Shërbimit Kombëtar Shëndetësor i 1946 vendosi sigurimin e shërbimeve falas për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve.
Sistemi Beverixh përfshin një pjesë të ndjeshme të ofruesve publike, që shpesh kanë personel që paguhet për këtë punë.

Bias (Njëanshmëri)
Devijimi i rezultateve nga e verteta ose procesi që çon në një devijim të tillë.Çdo tendence në grumbullimin, analizen, interpretimin, publikimin ose rishikimin e të dhënave që mund të çojë në konkluzionin se ato janë sistematikisht të ndryshme nga e vërteta.

Biennal Collaborative Agreement-BCA (Marrëveshje Dyvjeçare e Bashkëpunimit)
Nënkupton marrëveshjet dyvjeçare teknike të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Organizates

Botërore të Shëndetesisë. Normalisht nëshkruhet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Drejtori i Zyres Rajonale i OBSH-së për Evropën.

Biological agent (Agjent biologjik)
Një mikroorganizëm, virus ose ndonjë lëndë tjetër toksike, e cila përdoret si armë gjatë luftës.

Biological warfare (Lufta biologjike)
Përdorimi ushtarak i agjentëve të dëmshëm biologjike si bakterie patogjene.

Biotechnology (Bioteknologji)
Përdorimi në shkallë industriale i proceseve biologjike, më dukshëm në rastin e teknikave rikombinuese të ADN-së, për të riprodhuar barna ose (nëpërmjet tharmë-timit) prodhime ushqimore në masë për njerëzit ose kafshët, nganjëherë me anë të riqarkullimit të mbeturinave.

Bioterrorism (Bioterrorizëm)
Terrorizëm që përdor agjente biologjike. Mund të jenë virusë, bakterie, rikecie, kërpudha ose toksina biologjike

Bismarckian system (Sistemi i Bismarkut). Shih gjithashtu "Health care system "
Një sistem i sigurimit shëndetësor dhe social i futur në shekullin e 19 në Përandorinë Gjermane nën perandorin Bismark. Ky sistem është i detyrueshëm me ligj për shumicën ose për të gjithë popullsinë, në mënyrë që ajo të marrë sigurimin e caktuar nga një palë paguese e tretë përmes kontributeve që nuk lidhen me riskun dhe që janë të ndara nga taksat ose pagesat e tjera të vendosura me ligj.
Quhet gjithashtu sigurimi shëndetësor social. Kjo skemë përfaqësonte në parim një mënyrë për të shmangur impaktin e keq të papunësisë, varfërisë dhe sëmundjeve që prekin pjesë të gjëra të popullsisë.

Block contracts (Kontrata në bllok). Shih "Contracts"

Block grants (Grante në bllok)
Këto grante janë me shuma të pandara sipas zërave, të llogaritura në mënyrë prospektive, pra që më parë dhe të bazuara në kritere specifike, të cilët nuk mund të ndikohen nga autoritetet që i marrin këto grante për një periudhë afatshkurtër, për shembull grante që jepen mbi bazën e numrit të banorëve dhe shpërndarjen e tyre.
Këto lloj grantesh i referohen shpesh granteve nga qeveria për autoritetet lokale.

Blood bank (Banke gjaku).
Një vend ku grumbullohet gjaku nga dhuruesit, ku përcaktohet grupi, ndahet në komponente,ruhet dhe përgatitet për transfuzion

Blood screening (Kontroll i gjakut)
Nënkupton kontrollin laboratorik që i bëhet gjakut për të vërtetuar praninë e shkaktareve infektive,për shembull për HIV-in etj.

Breastmilk substitute (Zëvëndësues i qumështit të gjirit)
Një formulë ose qumësht që jepet në vend ose si shtesë e qumështit të gjirit.

Budget (Buxhet). Shih gjithashtu "Flexible/ Fixed/ Global/Open-ended budget"
Burime financiare që vihen në dispozicion për të siguruar një nivel të caktuar shërbimesh gjatë një periudhe të caktuar kohe ose për tu përdorur për një qëllim specifik.

Bureaucratic and political corruption (Korrupsioni burokratik dhe politik)
Kur politikanët apo burokratët përdorin pushtetin dhe ndikimin e tyre për të siguruar mbështetje elektorale. Për shembull ndërtimi i një spitali apo mosmbyllja e tij në një vend ku ai nuk nevojitet.

Burden of disease (Barre, peshë e sëmundjes)
Shpenzimet shëndetësore dhe social-ekonomike që rrjedhin nga një gjëndje e caktuar shëndetësore apo një sëmundje.

D

DALE. Shih, "Disability-adjusted life expectancy"

DALY.. Shih " Disability-adjusted life year"

Day cases (Raste ditore). Shih "Day care"

Day care (Kujdes ditor)
Shërbimet mjekësore dhe paramjekësore për pacientë që janë shtruar zyrtarisht për diagnostikim, trajtim ose tipe të tjera të kujdesit shëndetësor, me synimin për nxjerrjen e pacientit në të njëjtën ditë. Ndonjëherë njihet si rastet ditore

Death-to-case ratio (Raporti vdekje-rast)
Është numri i vdekjeve nga një sëmundje e caktuar gjatë një periudhe kohe të caktuar pjestuar me numrin e rasteve të reja të asaj sëmundjeje të identifikuar gjatë të njëjtës periudhë kohe.

Decentralization (Decentralizim). Shih gjithashtu "De-concentration" "Delegation", "Devolution","Privatization"
Ndryshimi i marrëdhënieve brënda dhe midis një serie strukturash organizative/organizmash, që çon në kalimin e autoritetit për të planifikuar, marrë vendime ose menaxhuar funksione publike nga niveli kombëtar në një organizatë apo agjensi në nivelin lokal.
Decentralizimi mund të marrë forma të ndryshme. Me kryesoret janë dekoncentrimi, devolucioni, delegimi dhe privatizimi.
Përkufizim plotësues: Kalimi i autoritetit ose shpërndarja e pushtetit në planifikim, menaxhim dhe vendim-marrje publike nga niveli kombëtar në nivelet lokale, ose në mënyrë më të përgjithshme nga një nivel më i lartë në një nivel më të ulet qeverisjeje.

Deconcentration (Dekoncentrim). Shih gjithashtu "Decentralization"
Kalimi i disa autoriteteteve administrative nga pushteti qendror tek zyrat lokale të ministrive qendrore.Në këtë rast kemi kalim vetëm të autoritetit administrativ dhe jo politik në një ose me shumë nivele më të ulta. Ky është quajtur modeli "ministror"
Për Ministrinë e Shëndetesisë kjo do të përfshinte në mënyrë tipike njesite e niveleve administrative subnacionale (rreth,distrikt,lokale) të Ministrisë së Shëndetesisë duke marrë përsipër detyra administrative që më parë kryheshin në nivel qendror, por duke mbetur nën vartesinë e qeverisë qendrore (për shembull autoritetet shëndetësore në nivele prefekture apo rrethi, bordet e menaxhimit shëndetësor etj)

Deductible (Një shumë që mbahet, që hiqet nga diçka). Shih gjithashtu "Cost-sharing"
Ndarje e kostos në formën e një sasie fikse e cila duhet paguar për një shërbim ose e një kostoje totale që lind gjatë një periudhe të caktuar nga një person i siguruar përpara se paguesi i një palë të tretë të mbulojë të gjithë ose një përqindje të kostos që mbetet.
Sasia që duhet të paguhet nga një person i siguruar me një kontrate të kujdesit shëndetësor përpara se përfitimet të bëhen të pagueshme. Në fakt është si një masë që shmang mbipërdorimin e shërbimeve.

Delegation (Delegim). Shih dhe "Decentralization"
Ti japësh një autoriteti të drejtën për të planifikuar dhe zbatuar vendimet lidhur me aktivitete të veçanta pa mbikqyrjen direkte nga një autoritet më i larte.
Përkufizim plotësues: Kalimi i përgjegjësive tek zyrat lokale ose organizatat jashtë strukturës së

qeverisë qëndrore si për shembull organizatat gati publike (jo-qeveritare), por me ruajtjen e kontrollit indirekt nga qeveria qëndrore.

Demographic information (Informacion demografik)
Karakteristikat e personit si mosha, seksi, raca dhe puna, të cilat përdoren në epidemiologjinë deskriptive për të karakterizuar popullatën në risk.

Denominator (Emërues)
Porcioni i poshtëm e një thyese që përdoret për të përllogaritur një shkallë apo një raport. Zakonisht emërues është popullata në risk

Dependant (I varur nga dikush tjetër, që nuk bën dot vetë)
Burri apo gruaja, femijet ose të afërm të tjerë të ngushtë të një personi i cili mbulohet nga një plan shëndetësor por pa paguar taksa, kontribute dhe premuime shtesë. Përgjithësisht mund të quhen familjarët e te siguruarit.

Dependent variable (Variabel e varur)
Në analizën statistikore është variabli përfundimtar ose variabli vlerat e të cilit janë funksion i vlerave të tjera (të quajtura variabla të pavarura)

Descriptive epidemiology (Epidemiologjia deskriptive)
Ai aspekt i epidemiollogjisë që merret me organizmin dhe përmbledhjen e të dhënave shëndetësore sipas kohes, vendit dhe personit.

Determinant (Faktor percaktues,determinant)
Çdo faktor,qoftë ngjarje, karaktetistikë ose ndonjë gjë tjetër e përcaktueshme, që sjell ndryshim në gjëndjen shëndetësore.

Devolution (Devolucion). Shih gjithashtu edhe "Decentralization"
Përfshin kalimin e përgjegjësisë dhe shkallës së pavarësisë tek pushteti rajonal ose lokal, me ose pa përgjegjësinë financiare (për shembull aftësia për të siguruar dhe shpenzuar të ardhura)
Quhet gjithashtu decentralizim politik. Ndryshe nga dekoncentrimi, këto institucione përgjithësisht janë të pavarur nga pushteti qëndror lidhur me funksionet dhe përgjegjesite e tyre.
Përkufizim plotësues: Kur qeveria heq dorë nga disa funksione duke ia lënë institucioneve të reja ose të ndryshme, jashtë kontrollit direkt të saj.
Devolucion do të thotë krijimi ose forcimi i niveleve subnacionale të qeverisë , që në thelb janë të pavarura nga niveli kombëtar në lidhje me një seri funksionesh. Ato mund të quhen pushteti rajonal ose lokal.

Diagnosis-based payment (Pagesë mbi bazën e diagnozes)
I referohet një mekanizmi në të cilin ofruesi ose institucioni i kujdesit shëndetësor merr një pagesë fikse, të paracaktuar për çdo rast të trajtimit të një individi me një diagnoze specifike.

Diagnosis-related group (Grup mbi bazën e diagnozes(DRG). Shih gjithashtu "Case payment"
Një mënyrë për kategorizimin e pacienteve sipas diagnozes dhe intensitetit të burimeve të kërkuara, zakonisht për kohën e qendrimit në spital. Pagesa sipas grupit të diagnozes është lloji më i zakonshëm i pagesave mbi bazë rasti.

DFID (Department for International Development)
Është departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar.Vepron në Shqiperi edhe në fushën e shëndetësisë.

Direct cost (Kostoja direkte). Shih "Cost"

Direct transmission (Transmetimi direkt)
Kalimi imediat i një agjenti nga rezervuari tek strehuesi i ndjeshëm përmes kontaktit direkt ose përmes spërklave.

Disability (Paaftësi)
Në konteksin shëndetësor çdo kufizim ose mungesë e aftësisë për të kryer një aktivitet në një mënyrë ose brënda atyre kufijve që quhen nomal për qëniet njerëzore.

Disability-adjusted life year -DALY (Vit jetë i modifikuar/korrigjuar duke marre parasysh paaftësinë). Shih gjithashtu "cost-utility analysis, QALY"
Një mënyrë për të matur peshën e sëmundjes së një popullsie. Ajo kombinon humbjen e jetës nga vdekja e parakoheshme me humbjen e jetës së shëndetshme nga paaftësia
Një vit jetë i llogaritur duke marrë në konsiderate paaftësinë (a disability-adjusted year, DALY) është një masë kohore e cila i lejon epidemiologet të llogarisin në një tregues të vetëm vitet e humbura të jetës shkaktuar nga vdekja e parakohshme (ku vdekje e parakoshme quhet ajo vdekje e cila ndodh përpara moshes në të cilen personi i vdekur pritej të mbijetonte nëse do të ishte anëtar i një popullate të standartizuar me një pritshmeri jetësore në lindje të barabarte me atë të popullatës boterore me jetëgjatësinë më të madhe, në Japoni) dhe vitet e jetuara në invaliditët me një gravitet dhe një kohezgjatjeje të caktuar. Një DALY është një vit me pak në jetën e shëndetshme.
DALE është pritshmeria e jetës në lindje duke marrë në konsiderate paaftësinë. Në dallim me metoden DALY, ajo nuk bën dallimin e kontributit të një sëmundje individuale me rezultatin e përgjithshëm.
Përkufizim plotësues: Një indikator i hartuar për të përcaktuar nga pikepamja sasiore peshën globale të sëmundjeve. Ai reflekton kufizime funksionale dhe vdekshmërinë e hershme, dhe modifikohet sipas moshes, seksit dhe kohëzgjatjes së sëmundjes.

Discharge (Nxjerrje, dalje nga spitali)
Përfundimi zyrtar i qëndrimit të pacientit në një spital ose ndonjë institucion tjetër shëndetësor ku ai është shtruar. Nxjerrja mund të jetë për në shtëpi, nga një spital në tjetrin dhe pas vdekjes.

Disease prevention (Parandalimi i sëmundjes)
Masa që synojnë jo vetëm parandalimin e shfaqjes së sëmundjes, si imunizimi ose kontrolli i vektorëve të sëmundjes ose aktivitetet kundër duhanit, por gjithashtu ndalimi i përparimit dhe reduktimi i pasojave të saj me t'u shfaqur sëmundja.

Disease control (Kontrolli i sëmundjes)
Është reduktimi i incidences së sëmundjes, prevalencës, sëmundshmërisë ose vdekshmërise si rezultat i përpjekeve të synimshme që kjo sëmundje të mos jetë më e një rëndësie për shëndetin publik. Kërkon ndërhyrje të vazhdueshme për ta ruajtur këtë reduktim.

Distribution (Përhapja, shpërndarja)
Në epidemiologji është frekuenca dhe tabloja e karakteristikave dhe ngjarjeve që lidhen me shëndetin në një popullate të caktuar.

Dispensary (Dispanseri)
Një institucion i specializuar ambulator, i cili mund të varet nga një spital ose të shërbejë si një institucion i pavarur.
Termi është përdorur më tepër për vendet e Evropes Lindore dhe ato në zhvillim
Përkufizim plotësues: Një institucion që merret me grupe sëmundjesh të veçanta ose me nëngrupe popullsie (sipas moshës ose gjendjes sociale). Përpjekjet kryesore të këtyre institucioneve synojnë parandalimin dhe diagnostikimin përmes kontrollit dhe monitorimit sistematik të grupeve të pacienteve, shpesh me ndihmen e fushatave masive, megjithëse këto institucione kanë gjithashtu edhe pajisje terapeutike.

District hospital (Spital rrethi)
Nënkupton një spital që për nga zona mbulon vetem një rreth. Zakonisht numërojnë 100-200 shtretër dhe ofrojnë katër shërbime bazë si sëmundjet e brëndëshme, pediatria, kirurgjia, obsteriko-gjinekologjia.

DPT-Vaksinë për parandalimin e difterisë, kolles së mirë dhe tetanozit. Për një mbrojtje të plotë nga këto sëmundje femija ka nevojë për vaksinimin bazë me tre injeksione 2 muajsh, 4 muajsh, 6 muajsh dhe tre rivaksinime 24 muajsh, 6 vjeç, 15 vjeç.

D O T S -Shkurtim në anglisht për "Direct Observed Treatment Short–Course „ (Trajtim Afatshkurter nën Vezhgimin Direkt)
Është strategjia e OBSH-së për luftimin e tuberkulozit.
Nga Banka Botërore përsa i përket analizës kosto/efektivitet mbahet si një prej ndërhyrjeve më të leverdisshme bashkë me imunizimin.

Droplet spread (Përhapje me stërkla)
Transmetimi direkt i një agjenti infektiv nga rezervuari drejt një strehuesi të ndjeshëm, përmes stërklave nga tështitja, kolla apo të folurit.

Drugs manifacturing (Prodhimi i barnave)
Prodhimi, kontrolli, amballazhimi dhe etiketimi i barnave.

Drug registration (Regjistrimi i barnave)
Procedura e shqyrtimit dhe studimit të dokumentacionit që përmban të dhëna të plota për çdo bar kimik, farmaceutik, biologjik, farmako-toksikologjik e kimik, si dhe kryerja e provave kimike kur kërkohet një gjë e tillë.

E

Earmarked taxes (Taksa të vëna mënjanë)
Taksa të cilat grumbullohen me qëllimin specifik për përdorimin e tyre për kujdes shëndetësor

E C H O.Shkurt në anglisht për "European Community`s Humanitarian Office "(Zyra Humanitare e Komunitetit Evropian)
E pranishme në Shqipëri që prej 1997 edhe në fushën e shëndetësisë.

Ecology (Ekologji)
Studimi i marrëdhënieve midis organizmave dhe midis organizmave e mjedisit të tyre jo të gjallë.

Economic analysis/evaluation (Analiza ekonomike/evaluacion)
Një analize që bëhet për alokimin e burimeve të pamjaftueshme për përdorime konkuruese alternative dhe shpërndarjen e produkteve nga këto përdorime mes anëtarëve të shoqërisë.
Tre tipe të zakonshme të analizës ekonomike janë:
Analiza kosto-efektivitet, një tip analize e cila krahason ndërhyrjet ose programet që kanë një matje të përbashkët të rezultateve shëndetësore në një situate ku, për një nivel të dhënë të burimeve, vendim-marrësi dëshiron të maksimalizojë përfitimet shëndetësore për një popullsi të caktuar.
Analiza kosto-dobi, është një tip analize që mat përfitimet të ponderuara në vite jete të dobishme (QALY) e cila nxjerr një raport të matjes së kostos për dobi duke dhënë mundësinë për krahasim midis programeve.
Analiza kosto-përfitim, është një tip analize që mat kostot dhe përfitimet në njësi monetare dhe nxjerr raportin përfitim monetar neto/humbje ose kosto/përfitim
Shprehja "analiza kosto-përfitim" ngandonjëherë përdoret si një term i përgjithshëm për evaluimin ekonomik.

Economic outcome (Rezultati ekonomik). Shih "Health outcome"
Rezultati i përdorimit të produkteve, shërbimeve dhe programeve të kujdesit shëndetësor që ndikojnë koston nisur nga një prej disa perspektivave.

Economics (Ekonomi). Shih gjithashtu "Health economics"
Studimi se si individet dhe shoqëritë zgjedhin alokimin e burimeve të kufizuara prodhuese midis alternativave konkuruese dhe shpërndarjen e produkeve tek anëtaret e shoqërisë.
Përkufizim plotësues: **Ekonomia e mirëqënies (Wellfare economics)** është disiplina e cila studion menyren sesi aktiviteti ekonomik mund të rregullohet sa më mirë që të jetë e mundur për të arritur maksimumin ekonomik dhe mirëqënien sociale.

Economies of scale (Ekonomite e shkallës,shkallëzimit). Në dallim me "Economies of scope"
Flasim për ekonomi të shkallëzimit kur kostoja mesatare për njësi ulet ndërsa rezultati rritet..Ky përcaktim ka të bëjë me madhësinë aktuale të ndërmarrjes, e cila ka tendencë të ketë kosto më të ulët nëse prodhon më shumë.
Përkufizim plotësues: Kur kostoja e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve ulet ndërsa numri i mallrave dhe shërbimeve rritet.

Economies of scope (Ekonomi të shtrijes-përfshirjes). Në dallim me "Economies of scale"
Përfitime nga prodhimi i mallrave ose shërbimeve të shumëllojshme (për shembull nëse është më e lirë të prodhosh si mallin "x" ashtu dhe atë "y" sëbashku sesa te ndara)
Ky përkufizim ka të bëjë me përfitimet nga prodhimi i produkteve të ngjashme.

Effectiveness (Efektivitet). Shih gjithashtu "Efficacy"dhe "Community effectiveness "
Se sa një ndërhyrje, një procedurë ose një shërbim specifik arrin atë synim për të cilin është menduar për një popullsi të caktuar.
Ka dy lloje efektiviteti, efektivitet efikas dhe efektivitet mbi komunitetin. Shpesh fjala efektivitet përdoret për këtë të fundit.
Përkufizim plotësues: Sa shumë arrihen objektivat.

Efficacy (Efikasitet). Shih gjithashtu "Effectiveness" dhe "Community effectiveness"
Përfitimi nga përdorimi i teknollogjisë për një problem në kushte ideale për shembull në një mjedis laboratorik, në kuadrin e një protokolli të një prove rastësore .
Në kushte ideale përcaktimi i efikasitetit bazohet në rezultatet e një prove kontrolli rastësor. Në krahasim me efektivitetin mbi komunitetin, efikasiteti zhvillohet në kushte ideale dhe të kontrolluara.

Efficiency (Efiçienca)
Sa arrihen objektivat duke minimizuar përdorimin e burimeve.
Ka dy tipe të efiçiences, teknike dhe alokative.
Përkufizim plotësues: Efiçienca është arritja e vlerës më të mirë të mundshme për burime të përdorura. Efiçienca teknike nënkupton prodhimin më maksimal të mundshëm të *output*-eve nga një seri e dhene *imput*-esh. Efiçienca alokative është kur burimet alokohen në mënyrë të tillë sa çdo ndryshim në sasinë ose tipin e *output*-it që po prodhohet aktualisht do të sillte një gjëndje më të mirë se sa me parë. Efiçienca alokative kërkon që një ekonomi ti sigurojë anëtareve të saj sasinë dhe tipin e mallrave dhe shërbimeve që ata preferojnë më tepër.

Eligibility (Të pasurit të drejtë)

Të pasurit të drejtë për diçka ,për shembull për të përfituar nga sigurimet shëndetësore

Elimination of disease (Eleminimi i sëmundjes)
Reduktimi në zero i incidencës së një sëmundjeje në një zonë të caktuar gjeografike si rezultat i një përpjekje të synimshme.Megjithate, ajo kërkon masa ndërhyrjeje te vazhdueshme.

ELISA (Enzyme-linked immunosorbent Assay)
Një metodë diagnostikuese që në bazë të saj ka një enzimë, dhe që përdoret për diagnostikimin e pranisë së kundërtrupave në gjak.

Emergency admission (Pranim emergjent, urgjencë)
Kur një pacient që shtrohet në të njëjtën ditë kur bëhet kërkesa për shtrim

Endemic disease (Sëmundje endemike)
Prania konstante e një sëmundje ose agjenti infektiv brenda një zone të caktuar gjeografike ose një grupi popullate.

Enrollees (I rekrutuar,i futur në listen e përfitimeve).Shih "Beneficiaries"

Entitlements (Të pasurit të drejtë për diçka)
Përfitimet në natyrë ose në pará, për të cilat përfituesit kanë të drejtë me ligj.

Environmental factor (Faktor mjedisor)
Një faktor i jashtëm (gjeologjia, klima, insektet, higjena, shërbimet shëndetësore etj) të cilët ndikojnë mbi agjentin dhe mundesinë për ekspozim.

Environemental health (Shëndet mjedisor)
Ato aspekte të shëndetit njerëzor dhe sëmundjes të cilat përcaktohen nga faktore të mjedisit. Ai përfshin si efektet direkte patollogjike të lëndeve kimike, rrezatimeve dhe disa agjenteve biologjike ashtu dhe efektet shpesh indirekte mbi shëndetin dhe mirëqënien e mjedisit të gjërë fizik, psikollogjik, social dhe estetik.

EPI - Shkurt në anglisht për "Expanded Programme on Immunisation" (Programi i Zgjeruar i Imunizimit)
Program i filluar nga OBSH-ja në vitin 1974 për të luftuar me anë të vaksinimit fillimisht gjashtë sëmundje si difteria, tetanozi, pertusi, fruthi, tuberkulozi dhe poliomieliti. Ky program përbën një prej arritjeve me të medha të shekullit te kaluar në shëndetin publik botëror.

Epidemic (Epidemi)
Shfaqja e sëmundjes në një numër shumë më të madh të rasteve të sesa ç'pritej, në një zonë të caktuar ose midis grupeve specifike të njerëzve për një periudhë të caktuar kohe.

Epidemic curve (Kurba epidemike)
Një histogram që tregon ecurinë e një shpërthimi të një sëmundjeje ose epidemie duke paraqitur numrin e rasteve nga koha e fillimit.

Epidemic period (Periudha epidemike)
Një periudhe kohore gjatë së cilës numri i rasteve të një sëmundje të raportuar është më i madh nga sa pritet.

Epidemiologic triad (Triada, treshja epidemiologjike)
Një model tradicional i shkaktimit të një sëmundje infektive. Përfshin tre komponentë, një agjent të jashtëm, një strehues të ndjeshëm dhe një mjedis i cili bashkon strehuesin dhe agjentin në mënyrë që të shfaqet sëmundja.

Epidemiology (Epidemiologji)
Studimi i përhapjes dhe i determinanteve të gjëndjes apo ngjarjeve shëndetësore në një popullate të caktuar dhe zbatimi i këtij studimi për të kontrolluar problemet shëndetësore.

Equality (Barazi)
Parimet, përmes së cilave të gjithë personat ose gjërat që merren në shqyrtim trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Equity (Drejtësi, paanshmëri, barazvendosje, ofrim i shanceve te barabarta,drejtesi-barazi)
Parimi i të qënit i ndershëm, i paanshëm ndaj të gjithëve në lidhje me një seri vlerash të përcaktuara dhe të pranuara.
Në shëndetësi kjo nënkupton se në mënyrë ideale çdo njeri duhet të këtë një shans të ndershëm ,duhet të arrije potencialin e plotë shëndetësor dhe në mënyrë më pragmatike askujt nuk duhet ti pengohet arritja e këtij potenciali, pra çdokush duhet të këtë akses gjeografik dhe financiar në burimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor
Ka dy lloje të ekuitetit: ai horizontal që është parimi që thotë se ata që ndodhen në rrethana identike ose të ngjashme duhet të paguajnë sasi të barabarta taksash (ose kontributesh) dhe duhet të marrin sasi të ngjashme përfitimesh dhe, drejtesia vertikale që është parimi që thote se ata që ndodhen në

rrethana të ndryshme në raport me karakteristikat e këtij ekuiteti duhet të trajtohen po në mënyrë të diferencuar, pra ata me mundësi më të madhe ekonomike duhet të paguajnë më tepër dhe ata me nevoja më të mëdha duhet të marrin më tepër shërbim

Eradication (Çrrënjosje)
Reduktimi i përhershëm në zero i incidencës botërore të infeksionit i shkaktuar nga një agjent i caktuar si rezultat i përpjekjeve të synimshme. Nuk nevojiten më masa ndërhyrëse.

Essential drugs (Barna thelbësore, esenciale). Shih gjithashtu
"Formulary"
Një iniciative politike për të siguruar se një numër minimal medikamentesh efektive është i disponueshëm për trajtimin e problemeve shëndetësore prioritare me një çmim që është i përballueshëm nga popullsia.
Një qëllim që lidhet me këtë është kursimi i burimeve që mund të përdoreshin duke dhënë me recente medikamente më të shtrejta, madje edhe të panevojshme.

Estimate: Vlerësim i përafërt

Evidence-based health care (Kujdes shëndetësor i bazuar në fakte)
Kujdesi shëndetësor i bazuar në fakte është një përdorim i ndërgjegjshëm i fakteve më të mira aktuale në marrjen e vendimeve lidhur me kujdesin për paciente individuale dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore.
Faktet aktuale më të mira nënkuptojnë informacionin nga një punë kërkimore përkatëse dhe e vlefshme lidhur me efektet e formave të ndryshme të kujdesit shëndetësor, dëmin potencial nga ekspozimi ndaj agjenteve të veçante, saktesinë e testeve diagnostike dhe forcën parashikuese te faktoreve prognostike
Përkufizim plotësues: Kujdesi shëndetësor i bazuar mbi fakte ndodh kur vendimet që ndikojnë në kujdesin e pacientit, merren siç duhet mbi bazën e një informacioni të vlefshëm dhe përkatës.

Evidence-based medicine (Mjeksi e bazuar në fakte)
Përdorimi i ndërgjegjshëm, i qartë dhe i kujdesshëm i fakteve më të mira aktuale në marrjen e vendimeve lidhur me kujdesin për pacientët individualë.
Praktika e mjeksisë të bazuar në fakte nënkupton integrimin e ekspertizës klinike individuale me faktet klinike më të mira të disponueshme nga puna kërkimore sistematike
Përkufizim plotësues: Analiza sistemike e informacionit lidhur me efektin e trajtimit dhe përdorimit të tij për të ofruar rezultate optimale shëndetësore.

Euro (EURO)
Me këtë emër njihet shkurtimisht Zyra Rajonale e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Evropën.

European Alcohol Action Plan (Plani Evropian i Veprimit i Alkolit)
Një plan i cili u hartua në vitin 1992 me synim stimulimin dhe ndihmën e vendeve evropiane anëtare të OBSH-së për të parandaluar rreziqet që i kanosen shëndetit dhe problemet sociale që rrjedhin prej alkolit.

Evaluation (Evaluacion)
Një proces që tenton të përcaktojë në mënyrë sa me simetrike dhe objektive që të jetë e mundur rëndësinë, efektivitetin dhe impaktin e aktiviteteve nën driten e objektivave të tyre
Exclusions: Sherbime shëndetësore qe nuk mbulohen nga polica e sigurimit shëndetësor te një personi.

Experience rating (Klasifikimi sipas përvojës)
Vendosja e një premiumi grup, bazuar mbi humbjet aktuale të përjetuara nga ai grup gjatë një viti më parë ose gjatë viteve të mëparshme

Experimental study (Studim eksperimental)
Një studim në të cilin studjuesi specifikon kategorinë e ekspozimit për çdo individ (prova klinike) ose të komunitetit (prova e komunitetit) pastaj ndjek individet apo komunitetin për të zbuluar efektet e ekspozimit.

Exposed group (Grupi i ekspozuar)
Një grup, anëtarët e të cilit janë ekspozuar ndaj një shkaktari të supozuar të sëmundjes.

Externality (Efekt nga brënda jashtë)
Rezultati i një aktiviteti që shkakton përfitime dytësore (efekte të dëshirueshme) ose dëme (shpenzime, ndotje) tek të tjerët, pa kompensim përkates ose pagesë prej atyre që e shkaktojnë këtë efekt të jashtëm. Gjithashtu quhen edhe efekte anësore ose efektet e kapërcimit të kufirit (derdhjes). *Përkufizim plotësues*: Kosto ose përfitime të cilat lindin nga prodhimi ose konsumi, të cilat bihen mbi individe ose grupe që nuk janë të përfshire direkt në prodhimin ose konsumin në fjalë dhe që nuk kompensohen. Për shembull, një ekternalitet përfitues është imunizimi i një individi ndaj sëmundjeve infektive i cili mund të bllokojë transmetimin e sëmundjes tek indvidet e tjere, të cilët nuk përfshihen direkt dhe që nuk paguajnë asgjë për këtë mbrojtje.

F

Family doctor (Mjeku i familjes)
Mjek, i cili ka për detyrë t'u sigurojë njerëzve një shërbim shëndetësor të gjërë që nga fillimi i jetës deri në vdekje dhe ti keshillojë ata për të gjithë aspektet e shëndetit, pavarësisht nga mosha, seksi, grupi etnik ose besimi.

F A O - Shkurt anglisht për "Food and Agricultural Organisation of the United Nation" (Organizata pcr Ushqimin dhe Bujqësinë e Kombeve të Bashkuara).
Themeluar në vitin 1945. Ka 158 vende anëtare. FAO kërkon të nxisë prodhimin bujqësor, pyjor, peshktarinë dhe të përmirësojë shpërndarjen e tyre. Gjithashtu ajo i jep asistence teknike qeverive të vendeve anëtare për përmirësimin e ushqyerjes. Qendra është në Romë.

Fee-for-service (Tarife për shërbim). Shih "Reimbursement" dhe "Payment". Në dallim me fjalën "Capitation"
Pagesa që i bëhet një ofruesi të shërbimeve shëndetësore për çdo akt apo shërbim që bën.
Përkufizim plotësues: Një mekanizëm pagese me anë të të cilit një ofrues i kujdesit shëndetësor ose një institucion i kujdesit shëndetësor paguhet sa herë që ofrohet një shërbim i rimbursueshëm (për shembull një vizitë, një procedurë kirugjikale, një test diagnostik etj). I referohet një metode rimbursimi për ofruesin e shërbimit shëndetësor. Ai paguhet për çdo shërbim të veçantë që i bën pacientit sipas një liste tarifash.

Fee schedule (Skeda, lista e tarifave)
Një listë e miratuar tarifash për çdo shërbim që propagandohet nga një kompani sigurimesh, agjensi qeveritare ose një shoqëri profesionistësh.

Financial resource allocation (Alokimi i burimeve financiare)
Çdo proces me anë të të cilit burimet financiare rrjedhin nga një pagues i një palë të tretë (për shembull qeveri, sigurues etj) përmes një institucioni të kujdesit shëndetësor tek ofruesi klinik i veçantë.

Financing (Financim)
Nxjerrje,gjetje, sigurim i të ardhurave për të paguar mallrat ose shërbimet
Përkufizim plotësues: Funksion i sistemit shëndetësor që merret me mobilizmin, grumbullimin dhe alokimin e parave për të mbuluar nevojat shëndetësore, veç apo bashkarisht në sistemin shëndetësor.

Fixed budget (Buxhet fiks). Në dallim me "Flexible budget"
Një buxhet që nuk modifikohet nga ndryshimet në volumin e shërbimeve

Fixed cost (Kosto fikse). Shih "Cost"

Fringe benefits: Perfitime shtesë,suplementare

Flexible budget (Buxhet fleksibel) në dallim me "Fixed budget"
Një buxhet që modifikohet sipas ndryshimeve në volumin e shërbimeve

Food safety (Siguri ushqimore)
Nënkupton se sa të sigurtë janë ushqimet që hamë nga pikëpamja shëndetësore.

Food security (Sigurimi i ushqimit)
Nënkupton te siguruarit e ushqimit për të ngrënë.

Foreing aid (Ndihmë e huaj)
Transferimi i fondeve publike në formën e borxheve ose granteve, të dhëna ose direkt nga një qeveri tek tjetra (ndihma dypalëshe) ose indirekt përmes agjensive ndërkombëtare ose shumëpalëshe si Banka Boterore etj.

Funding (Dhënie fondesh, financim)
Të sigurosh institucionet e kujdesit shëndetësor me burime financiare që duhen për të kryer një seri të përgjithshme aktivitetesh që lidhen me shëndetin.
Ngandonjehere përdoret në vend të fjalës financim ose për të përshkruar procesin e grumbullimit të parave për ti dhene fonde kujdesit shëndetësor.

Fundholding (Mbajtje e fondeve)
Një sistem pagese për kujdesin mjeksor, i cili ka karakteristikat e meposhtme: Burimet financiare për kujdesin shëndetësor alokohen për frymë. Burimet fianciare ruhen në një fond dhe mjeku i përgjithshëm zakonisht është vendim-marrësi për alokimin e fondeve.

G

Gatekeeper (Portjer)
Një mjek i kujdesit shëndetësor parësor (ose ndonjë ofrues tjetër) i cili është përgjegjës për mbikqyrjen dhe koordinimin e të gjitha nevojave mjekësore të pacientit. Portjeri duhet të autorizojë çdo rekomandim të pacientit tek një specialist ose një spital.
Me përjashtim të rasteve të urgjencës, ky lloj autorizimi duhet të jepet përpara se të fillojë kujdesi shëndetësor. Funksioni i portjerit është një mënyrë për ta larguar pacientin nga vetërekomandimi i panevojshëm drejt shërbimeve të specializuara të kushtueshme.

GAVI (Global Alliance for Vaccines and Immunisation)
Aleanca Globale për Vaksinat dhe Imunizimin (GAVI) është një koalicion ndërkombëtar partneresh. Ajo përfshin qeveritë nacionale, organizatat ndërkombëtare si psh. Fondi i Kombeve të Bashkuara të Fëmijeve (UNICEF), Organizata Botërore e Shëndetesisë (WHO) dhe Banka Botërore, Institucionet bamirëse, si psh. Programi i Vaksinimit të Femijeve Bill dhe Melinda Gates dhe Fondacioni Rockfeler, sektori privat i përfaqësuar nga Federata Ndërkombëtare e Shoqatave te Manifakturave Farmaceutike dhe institucionet kërkimore dhe të shëndetit publik. Aleanca u krijua zyrtarisht në Davos të Zvicrës në Janar 2000.

GDP (xhi-di-pi).Shih "Gross domestic product"

Gender mainstreaming
Përfshirja e çështjeve gjinore në rrymën e përgjithshme të zhvillimit

Gender sensitivity (Ndjeshmëria gjinore)
Përfshirja e perspektivës gjinore në politikat dhe strategjitë shëndetësore. Një perspektivë e tillë çon në një kuptim më të mirë të fakteve që ndikojnë në shëndetin e grave dhe burrave. Kjo nuk merret vetëm me dallimet biologjike midis grave dhe burrave ose me rolin riprodhues të grave, por pranon edhe efektet e marrëdhenieve, roleve dhe përgjegjësive të përcaktuara nga aspektet sociale, kulturore dhe ato të sjelljes veçanerisht për shendetin individual, të familjes dhe të komunitetit.

General (medical) practitioner-GP (Mjek i përgjithshëm). Shih gjithashtu "Physician"
Një mjek i përgjithshëm ose mjek i familjes, i cili është pika e parë e kontaktit me shërbimet shëndetësore për të gjitha rastet jo urgjente.

Generic drugs (Medikamente xhenerike)
Medikamente të cilat janë identike nga pikëpamja kimike me preparatin farmaceutik të prodhuar nga një firmë, e cila i ka dhënë emrin e vetëm si prodhuese e tij, por që prodhohen nga konkurentë, pasi firmës i ka skaduar patenta për atë medikament.

Global budget (Buxhet global). Shih gjithashtu "Budget"
Një shumë parashë totale, e fiksuar që më parë, me anë të të cilës synohet të mbulohet kostoja totale e shërbimeve, zakonisht për një vit.
Një tip i buxhetit fiks që siç e tregon edhe fjala flet se paguesi i buxhetit i lë hapësirë marrësit të buxhetit (për shembull spitalit) për të vendosur se në çfarë zërash ta shpenzojë paranë.
Përkufizim plotësues: Pagesa e një shume të caktuar për të mbuluar shpenzimet operative të shërbimeve të ofruara nga një spital në një periudhe të dhënë kohe.

Global Fund for HIV/AIDS, TB and Malaria (Fondi global për HIV/AIDS, TB dhe Malarien)
U ngrit në janar 2002 si një instrument financiar, plotësues i programeve ekzistuese për këto sëmundje. Qëllimi i Fondit Global është që të tërheqë, menaxhojë dhe nxjerrë burime shtesë përmes partneritetit privato-publik. Kjo do të çonte në një pakësim të infeksioneve, sëmundjeve edhe vdekjeve të shkaktuara nga këto tre sëmundje.

Goal (Qëllim). Shih gjithashtu "Objective"
Një synim i përgjithshëm drejt të cilit tentohet të shkohet Deklarim i një gjëndje ose qëllimi të deshirueshëm për të ardhmen.
Një qëllim ndryshon nga një objektiv pasi ka një afat më të gjatë dhe zakonisht është i gjërë. Brënda sektorit shëndetësor OBSH-ja e ka përcaktuar qëllimin e "Shëndetit për të gjithë në vitin 2000" i cili thote se " Si minimum të gjithë njerëzit në të gjitha vendet duhet të kenë të paktën atë nivel të shëndetit që ata të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë prodhuese dhe të marrin pjesë aktive në jetën sociale të vendit në të cilin jetojnë". Përveç kesaj OBSH-ja pranon se " që të arrihet një nivel i tillë i shëndetit, çdo individ duhet të këtë akses në kujdesin shëndetësor parësor dhe përmes tij në të gjitha nivelet e një sistemi të shtrirë shëndetësor".
Qëllimi shëndetësor: Qëllimet shëndetësore përmbledhin rezultatet e shëndetit, që një vend apo një komunitet mund të shpresojë të arrije në një periudhe të caktuar kohe nën driten e njohurive dhe burimeve ekzistuese.

Good (Mall)
Term që nënkupton produkte të prekshme, konkrete që kontribuojnë në përmbushjen e kërkesës. Për të plotësuar kërkesën shërbimet shëndetësore tentojnë të kombinojnë përdorimin e mallrave me shërbimet
Përkufizim plotësues: Mallra meritë janë ato mallra që i ofrohen publikut përmes vendimeve politike. Në këtë rast jo domosdoshmerisht mallrat kërkohen nga publiku, ose të paktën nuk kërkohen në sasinë e ofruar, por sipas politikaneve publiku duhet ti këtë ato në interes të tij
Mallra superiore janë ato mallra dhe shërbime, për të cilat kërkesa rritet me rritjen e të ardhurave.

Governance (Qeverisje)
Të ushtruarit e autoritetit politik, ekonomik dhe administrativ në menaxhimin e punëve të një vendi në të gjitha nivelet.
Që nga futja e fjales "stewardship"(të kujdesurit), termi "qeverisje" ndonjëherë reduktohet në marrëdhënien midis pronareve dhe menaxhimit të një organizate, domethënë qeverisja e spitaleve private do të ushtrohej nga pronarët e tij të interesuar për shembull që të nxjerrin përfitime, ndërsa roli "stewardship" i qeverisë do të synonte sigurimin për shembull të aksesit, dhe kostove të pranueshme nga pikëpamja sociale. Megjithatë si fjala "governance" ashtu dhe fjala "stewardship" nuk përkthen kollaj në gjuhë të tjera.

Grant
Fond i dhënë për një qëllim të veçantë një personi ose një institucioni, i cili nuk kthehet mbrapsht.

Gross domestic product-GDP (Produkti i brendshëm bruto-(xhi-di-pi)
Vlera monetare e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend, në një ekonomi, gjatë një viti.
Vlera totale në pará e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi gjatë një periudhe kohe të caktuar (zakonisht një vit), plus të ardhurën neto nga prona prej investimeve jashtë shtetit.

Ground water (Ujra nëntokësore)
Nënkupton ujrat e pastra të pijshme

Guidelines (Udhëzues). Shih gjithashtu “Clinical guidelines”
Një seri hapash të cilat mund të ndërmerren në kryerjen e një detyre ose në zbatimin e një politike dhe mënyra e bërjes së një gjëje të tillë.
Ngandonjëherë të quajtura direktiva klinike, të cilat ofrojnë hapat dhe mjetet për një diagnoze dhe trajtim të duhur.
Përkufizim plotësues: Udhezuesit janë mjete për të asistuar në një proces drejt arritjes së rezultatit.

H

Health (Shëndet)
Është një gjendje e mirëqënies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo vetëm mungesa e sëmundjes apo të qënit i pamundur.

Health benefit (Përfitim shëndetësor)
Në ekonominë e shëndetit një përfitim shëndetësor është ai i cili siguron një përfitim nga pikepamja e reduktimit të kostos ose përmirësimit të shëndetit.

Health care (Kujdes shëndetësor)
Çdo tip shërbimi që ofrohet nga specialistet ose paraspecialistet me një impakt në statusin shëndetësor.
Përkufizim plotësues: Mallra dhe shërbime që përdoren si impute për të prodhuar shëndet. Në disa analiza, është koha dhe njohuritë e përdorura për të ruajtur dhe promovuar kujdesin shëndetësor, plus *imput*-eve të kujdesit shëndetësor konvencional

Health care professional (Profesionist i kujdesit shëndetësor)
Një individ i cili është trajnuar në një specialitet ose është arsimuar në një fushë që ka të bëjë me shëndetin. Kjo mund të përfshije administraten, ofrimin direkt të kujdesit shëndetësor për pacientin, dhe shërbimet ndihmëse.

Health care system (Sistemi i kujdesit shëndetësor). Shih gjithashtu "Health system" , "Beveridge/Bismarckian/Semashko system", "Social health insurance","Contract/ Integrated model"
Një strukturë zyrtare për një popullsi të caktuar, financimi, menaxhimi, shtrirja dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet me ligj dhe rregullore.
Ai siguron shërbime për njerëzit për të kontribuar në shëndetin e tyre dhe ofrohet në mjedise të caktuara si shtëpi, institucione arsimore, vende pune, vende publike, komunitetete, spitale dhe klinika.
Sistemi i kujdesit shëndetësor (ofrimi) i referohet shërbimeve të kujdesit shëndetësor që kryhen në sektorin e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Është sistemi që merret me masat mjekësore dhe terapeutike që synojnë të ruajnë dhe përmirësojnë kushtet shëndetësore të pacientit.
Përkufizim plotësue: Një seri elementesh dhe lidhjet e tyre në teresinë komplekse, të ngritur për ti shërbyer nevojave shëndetësore të popullsisë.

Health centre (Qendër shëndetësore)
Një institucion që ofron shërbime mjekësore dhe sanitare (ambulatore) për një grup specifik në një popullsi.
Idealisht ky shërbim duhet të përfshije a) kujdes mjekësor dhe sanitar (si parandalues ashtu dhe promovues të shëndetit) për individe, familje dhe grupe të tjera specifike dhe shoqërinë si një të tërë b) kujdes mjeksësor për pacientet si brënda qendrës shëndetësore ashtu dhe në shtëpi dhe c) shërbime rehabilituese bashkë me institucionet e mirëqënies sociale. Në Evropen Lindore këto quheshin dispanseri dhe poliklinika. Në perëndim mund të quhen praktikat e mjekëve ose qendrat e komunitetit.

Health competence (Kompetence shëndetësore)
Kompetencë individuale për të ndikuar faktoret që përcaktojnë shëndetin.

Health determinants (Faktorë përcaktues të shëndetit)
Seria e faktorëve personalë socialë, ekonomikë dhe mjedisorë të cilët përcaktojnë statusin shëndetësor të individeve ose të një popullsie. Faktorët që ndikojnë shëndetin janë të shumtë dhe interaktive. Promocioni shëndetësor në thelb merret me veprimin dhe avokacinë e determinateve të shëndetit që janë të modifikueshëm, dhe jo vetëm me ata që lidhen me veprime të indvideve siç janë sjelljet e shëndetshme dhe menyra e jetesës por edhe faktore si të ardhurat dhe statusi social, arsimi, punësimi dhe kushtet e punës, aksesi tek shërbimet e përshtatshme shëndetësore dhe mjedisi fizik

Health development (Zhvillimi i shëndetit)
Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm progresiv të statusit shëndetësor të popullsisë

Health economics (Ekonomia e shëndetit)
Disiplina e ekonomisë e zbatuar në shëndetësi. Ajo përpiqet ti japë përgjigje pyetjeve të tilla si :Sa prej burimeve të shoqërisë i dedikohen shëndetësisë ? Çfarë përparesie i jepet aspekteve të ndryshme të shëndetesisë dhe shërbimeve shëndetësore? Për çfare shërbimesh shëndetësore njerëzit janë gati të paguajnë? Cilat janë shpenzimet e drejtpërdrejta dhe terthore? Cili është impakti i shërbimeve shëndetësore në ekonominë e vendit etj.

Health education (Edukimi shëndetësor)
Procesi i planifikuar dhe i menaxhuar, i investimit në edukim për të arritur përmirësimin në shëndetin e popullsisë.

Health expectancy (Pritshmëria e shëndetit)
Tregon sipas normave dhe perceptimeve sociale dhe standarteve profesionale proporcionin e asaj pjese të jetës që pritet të jetë e shëndetshme dhe e përmbushur, pa sëmundje dhe paaftësi.

Health expenditure (Shpenzim shëndetësor). Shih "Public health care expenditure" "Private health care expenditure" dhe " Total expenditure on health"

Health facility (Institucion, ndërtesë shëndetësore)
Një ndërtesë ku ushtrohet mjekësia

Health for All (Shëndet për të Gjithë)
Arritja nga të gjithë njerëzit e botës i një niveli të shëndetit që do ti lejonte ata të bënin një jetë produktive nga pikëpamja sociale dhe ekonomike.

Health for All policy (Politika e Shëndetit për të Gjithë)
Politikë e cila bazohet në parimet e barazisë dhe pjesëmarrjen demokratike në marrjen e vendimeve, pra në vlerat e shëndetit për të gjithë. Ajo merret me menyren (stilin) e jetesës, mjedisin dhe kujdesin shëndetësor. Lançuar nga OBSH në 1978.

Health gain (Fitim në shëndet, përmirësim në shëndet)
Një përmirësim i matshëm në shëndetin e një individi ose popullsie, përfshire jetëgjatësinë dhe cilesinë e jetës.

Health impact assessment (Vlerësimi i impaktit shëndetësor)
Një vlerësim i të gjitha efekteve te drejtpërdrejta apo tërthorta të një politike, programi, shërbimi ose institucioni mbi gjendjen shëndetësore dhe mbi gjithë zhvillimin shëndetësor dhe social-ekonomik

Health indicator (Indikator, tregues shëndetësor)
Indikatori shëndetësor është një karakteritikë e një individi, popullate ose mjedisi i cili matet (direkt ose indirekt) dhe mund të përdoret për të përshkruar një ose më tepër aspekte të shëndetit të një individi ose popullsie (cilesinë, sasinë dhe kohën)

Health information system (Sistemi i informacionit shëndetësor)
Një kombinim i statistikave shëndetësore nga burime të ndryshme që përdoret për të nxjerre informacion lidhur me gjendjen shëndetësore, kujdesin shëndetësor, ofrimin edhe përdorimin e shërbimeve shëndetësore dhe impaktin mbi shëndet.

Health insurance (Sigurim shëndetësor)
Një mekanizem me anë të të cilit merret para për pagimin e shërbimeve shëndetësore prej kontributeve. Pagimi mund të jetë vullnetar dhe i detyrueshëm. Kontributet e sigurimeve shëndetësore mund të kombinohen edhe me pagesa për përfitime të tjera sociale e në këtë rast ajo quhet një skemë e sigurimit social.

Health insurance fund (Fondi i sigurimeve shëndetësore). Shih "Sickness fund"

Health Insurance Institute (Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor)
Krijuar në 1 mars 1995. Mbulon një pjesë të çmimit të barnave në rrjetin e hapur farmaceutik dhe shpenzimet për mjekun e përgjithshëm dhe të familjes.

Health outcome (Rezultat shëndetësor)
Ndryshime në gjendjen shëndetësore (sëmundshmëri, vdekshmëri) që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve shëndetësore.
Rezultati klinik është efekti ose mungesa e efektit të një ndërhyrjeje të kujdesit shëndetësor mbi gjendjen shëndetësore.

Health plan (Plan shëndetësor)
Një term i gjërë për të gjitha llojet e skemave publike apo private të mbulimit me kujdes shëndetësor përfshire për shembull sistemet kombëtare shëndetësore, skemat e sigurimeve shëndetësore dhe skemat e sigurimeve shëndetësore private.

Health policy (Politike shëndetësore)
Një seri vendimesh, zotimesh publike ose procedurash zyrtare brenda institucioneve (kryesisht qeverisë) të cilat përcaktojnë prioritetet dhe parametrat për veprim në përgjigje të nevojave shëndetësore, burimeve të disponueshme dhe trysnisë politike.
Shpesh politika shëndetësore vihet në jetë përmes legjislacionit ose formave të tjera të drejtimit, të cilat përcaktojnë rregulloret dhe stimujt që bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe programeve dhe aksesin tek këto shërbime dhe programe.

Health post (Ambulancë)
Njesia me e vogel funksionale e sistemit shëndetësor. Kërkesa minimale është prania e një mami-infermiereje

Health potential (Potencial shëndetësor)
Niveli më i plotë i mundëshm i shëndetit që mund të arrijë ndonjë individ. Potenciali shëndetësor përcaktohet nga kujdesi për vehten dhe për të tjeret, nga të qënit të aftë për të marrë vendime dhe për të pasur kontroll mbi jetën tënde dhe duke siguruar që shoqëria në të cilën jetohet krijon kushtet që lejojnë arritjen e shëndetit nga të gjithë anëtaret e saj.

Health professional (Profesionist i shëndetit)
Një person që ndihmon në identifikimin dhe trajtimin e sëmundjes ose një paaftësie. Shpesh përdoret si sinonim për mjekun.

Health promotion (Promocion shëndetësor)
Është shkenca dhe arti për të ndihmuar njerëzit që të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës drejt një gjendje optimale shëndeti ose procesi i aftësimit të individëve dhe bashkësive të tyre për të rritur kontrollin mbi determinantet e shëndetit, duke përmirësuar keshtu shëndetin e tyre. Është në fakt një kombinim i informacionit, edukimit ,kontrollit diagnostik dhe ndërhyrjeve në fushën e kujdesit shëndetësor për të lehtësuar ndryshimet në sjellje që do të përmirësonin shëndetin dhe do ta mbronin atë.

Health Promoting Schools (Shkollat e Promocionit Shëndetësor)
Shkolla të cilat synojnë arritjen e një mënyrë të shëndetshme të jetesës për të gjithë nxenësit e shkollës, duke zhvilluar mjedise mbështetëse që çojnë në një promocion të shëndetit. Shqipëria është pjesëtare e këtyre projekteve.

Health Promotion Hospital (Spital i promocionit shëndetësor)
Një spital i cili përpiqet të përfshije kulturen e promocionit shëndetësor në mjedisin spitalor, me synim përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, kushtet e punës dhe kenaqjen e stafit, pacientëve dhe familjarëve.

Health resources (Burimet shëndetësore). Shih gjithashtu "Input"
Mjetet e disponueshme për venien në punë të sistemit shëndetësor,përfshire burimet njerëzore, institucionet, pajisjet dhe bazën materiale,fondet financuese dhe njohuritë.

Health sector (Sektori shëndetësor)
Sektor që konsiston në shërbime të organizuara publike dhe private (duke përfshire promocionin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve, diagnostikimin, trajtimin dhe kujdesin shëndetësor), politikat dhe veprimtarite e departamenteve shëndetësore dhe ministrive, OJQ-të që kanë të bëjnë me shëndetin dhe grupe të ndryshme komunitetesh dhe shoqata profesioniste.

Health services (Shërbime shëndetësore)
Çdo shërbim i cili mund të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit apo diagnozes, trajtimit dhe rehabilitimit të njerëzve të sëmure dhe jo domosdoshmerish i kufizuar tek shërbimet mjekësore apo tek kujdesi shëndetësor
Shpesh me një përdorim më të kufizuar duke iu referuar shërbimeve të kujdesit shëndetësor, domëthëne atyre brenda sistemit të kujdesit shëndetësor.

Health service production (Prodhimi i shërbimeve shëndetësore)
Nënkupton të gjitha llojet e shërbimeve shëndetësore që i ofrohen qoftë individit ashtu dhe komunitetit

Health services research (Kërkimi, puna kërkimore lidhur me shërbimet shëndetësore)
Një fushe kërkimesh, e cila shqyrton impaktin e organizimit, financimit dhe menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor mbi ofrimin, cilësinë, koston, aksesin dhe rezultatet e shërbimeve të tilla.

Health services purchasing power parity (Fuqia ekuivalente e blerjes së shërbimeve shëndetësore). Shih "Purchasing power parity"

Health status (Gjendja, statusi shëndetësor)
Term për gjendjen shëndetësore të një individi, grupi ose popullate, e matur sipas standarteve, indikatoreve të përcaktuar.

Health system (Sistemi shëndetësor). Shih gjithashtu "Health care system"
Njerëzit, institucionet dhe burimet të rregulluara sëbashku në përputhje me politika të përcaktuara, për të përmirësuar shëndetin e popullsisë të cilës i shërbejnë, duke iu përgjigjur shpresave legjitime të popullsisë dhe duke e mbrojtur atë ndaj kostos së sëmundjes përmes një seri aktivitetesh.Qëllimi kryesor i tij është përmirësimi i shëndetit.Sistemi shëndetësor është një term i gjerë, i cili përfshin si sistemin e kujdesit shëndetësor dhe aktivitetet e tjera,qëllimi kryesor i të cilit është të promovojë, riktheje dhe ruajë shëndetin (për shembull një mjedis i sigurtë, rrypat e sigurimit në automjete)

Health System Strategy (Strategjia e Sistemit Shëndetësor)
Është dokumenti i strategjisë dhjetëvjeçare 2001-2110 i hartuar nga Ministria e Shëndetësise me asistencën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Deri ne tetor të vitit 2002 në formë drafti.

Health target (Shënjestër shëndetësore). Shih gjithashtu "Goal"
Shënjestrat shëndetësore për një popullatë të caktuar flasin për atë se sa i madh është ndryshimi (duke përdorur një indikator shëndetësor) i cili mund të pritet në mënyrë të llogjikshme brënda një kohe të caktuar. Përgjithësisht shënjestrat bazohen në ndryshime specifike dhe të matshme të rezultateve (të ndërmjetme) shëndetësore.

Health technology (Teknollogjia shëndetësore). Shih gjithashtu "Health technology assessment"
Zbatimi i njohurive shkencore në zgjidhjen e problemeve shëndetësore
Përkufizim plotësues: Sipas një vlerësimi të Zyres Amerikane të Teknologjisë teknologjite shëndetësore janë medikamentet, pajisjet, procedurat dhe sistemet e mbështetjes organizative brënda të cilave ofrohet kujdesi shëndetësor.

Health technology assessment (Vlerësimi i teknologjisë shëndetësore).
Vlerësim i gjërë i teknologjive ekzistuese dhe atyre të reja përfshirë medikamentet, procedurat, shërbimet, pajisjet lidhur me efektet e tyre mjekësore, ekonomike, sociale dhe etike.
Gjithashtu quhet edhe vlerësimi i teknollogjisë në kujdesin shëndetësor. Ai mund të trajtojë pasojat e drejtpërdrejta të teknologjisë ashtu dhe ato të terthorta. Qëllimi kryesor i tij është të mbajë të informuar politikëbërësit lidhur me kujdesin shëndetësor.
Përkufizim plotësues: Vlerësimi sistematik i vetive, efekteve dhe/ose impakteve të teknologjisë së kujdesit shëndetësor. Vlerësimi i teknologjisë shëndetësore përcakton një aktivitet multidisiplinar që sistematikisht ekzaminon rendimentin teknik, sigurinë, efikasitetin klinik, efektivitetin, koston, kosto-efektivitetin, impaktin organizativ, pasojat sociale, aspektet legale dhe etike të zbatimit të teknologjisë së shëndetit.

Healthy city (Qytet i shëndetshëm)
Është një qytet i cili në mënyrë të vazhdueshme krijon dhe përmirëson ato mjedise fizike dhe sociale, zgjeron ato burime të komunitetit të cilat i mundësojnë njerëzit të mbështesin njeri tjetrin në kryerjen e të gjitha funksioneve të jetës dhe në zhvillimin e një potenciali të plotë të tyre. Projekti "Qytete të Shëndetshme" është një projekt zhvillimi afat-gjatë i cili kërkon të vendosë

shëndetin në axhenden e vendimemarrësve në qytetet e Evropes dhe të ndërtojë një avokaci për shëndetin publik në nivel lokal.

Healthy company (Kompani, shoqëri e shëndetshme)
Parimet e shoqërisë së shëndetshme përfshijnë një mjedis pune të sigurt, praktika pune të shëndetshme, programe të promocionit shëndetësor dhe që trajtojnë faktoret psiko-sociale të riskut, vlerësimet e impaktit shëndetësor të prodhimeve që tregtohen dhe kontributin në shëndet dhe në zhvillimin social në komunitet.

Healthy public policy (Politike publike e shëndetshme)
Një interes i hapur për shëndetin dhe drejtesinë në shëndet në të gjitha sferat e politikes dhe përgjegjesisë për impaktin shëndetësor. Qëllimi kryesor është krijimi i një mjedisi mbështetës për ti bërë njerëzit të aftë që të bëjnë një jetë të shëndetshme.

Health workforce (Fuqia punëtore shëndetësore). Shih "Human resources"

Herd immunity (Imuniteti i grupit)
Rezistenca e një grupi ndaj invazionit dhe përhapjes së një agjenti infektiv, bazuar mbi rezistencën ndaj infeksionit nga një proporcion i madh individësh, anëtarë të atij grupi

High risk behaviours (Sjellje me risk të lartë)
Janë ato sjellje që kanë shumë mundesi që të çojnë drejt një infeksioni si seks i pambrojtur (anal,vaginal, ndonjëherë edhe oral) përdorimi i shiringave të kontaminuara, renia në kontakt me lengje të trupit si gjaku, sperma, lëngu vaginal dhe ndoshta edhe pështyma edhe pse jo e zakonshme.

High-risk group (Grup me risk të lartë)
Një grup brenda një popullate që paraqet risk të lartë ndaj sëmundjes

HiT (Health Care System in Transition-Sistemi i Kujdesit Shëndetësor në Tranzicion)
Janë publikime përshkruese analitike mbi kujdesin shëndetësor të çdo vëndi. frut i një bashkëpunimi të OBSH-së me disa vende Evropiane Përëndimore si dhe me vendin përkatës. Për Shqipërinë ekziston një HiT i publikuar në 1999. Deri tani ata janë vetëm në anglisht. Gjenden edhe në internet në faqen e OBSH-së.

H I V - Shkurt në anglisht për "Human immunodeficiency Virus" (Virusi i pamjaftueshmërisë imunitare)
Retrovirusi që shkakton AIDS-in.

Home care (Kujdes në shtëpi)
Shërbime mjekësore dhe paramjekësore që i ofrohen pacienteve në shtëpi.
Ketu përfshihen shërbimet obstetrike në shtëpi, dializa shtëpijake,shërbimet telematike etj.
Përjashtohen konsumi i mallrave mjekësore (medikamente dhe mallra të tjera mjekësore) që i jepen pacienteve të jashtëm si pjesë e konsumit privat shtëpijak.

Horizontal equity (Ndershmëri, ekuitet horizontal). Shih "Equity"

Horizontal survey (Studim horizontal)
Një studim i një popullate, ndoshta i stratifikuar sipas moshës, seksit, etnisë etj, por që bëhet në një moment kohor të caktuar.

Hospital (Spital)
Një institucion qendrimi me pajisje për pacientë të shtruar për kujdes mjekësor dhe infermieristik 24 orësh, për diagnonstikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurit apo aksidentuarit, zakonisht për gjendje mjekësore dhe kirurgjikale dhe i pajisur me të paktën një mjek. Spitalet mund të ofrojnë gjithashtu edhe kujdes për pacientë të pashtruar.

Hospital bed (Shtrat spitalor)
Një shtrat i rregullt dhe i pajisur me personel për akomodimin dhe përkujdesjen gjatë gjithë kohës të pacientëve të shtruar, i vendosur në një pavion ose zonë të spitalit ku ofrohet kujdes mjekësor i vazhdueshëm. Është një tregues që mat kapacitetin spitalor.
Shtratet spitalore përjashtojnë krevatet e vegjël për të sapolindurit, shtratet ditore, shtratet e improvizuar dhe të përkohshëm, shtratet që ndodhen në magazina, shtratet për qëllime të veçanta si për dializa apo për lindje. Database-i i OBSH-së numëron numrin e shtrateve spitalore si dhe shtratet spitalore në spitalet e kujdesit akut dhe shtratet në spitalet psikiatrike.Të dhenat e OECD-së aktualisht e shmangin përdorimin e termit "shtrat spitalor" dhe përdorin termin" shtrat për pacientet e shtruar" të cilët ndahen në "shtrate të kujdesit akut"dhe "shtrate të kujdesit psikiatrik" dhe "shtrate të kujdesit afatgjatë"

Hospital infections (Infeksione spitalore)
Janë ato infeksione që një pacient i merr në spital pas shtrimit në të. Përbëjnë një shqetesim të madh pasi shumë prej tyre janë rezistent ndaj antibiotikëve

Host (Strehues)
Një person ose një organizëm tjetër i gjallë që mund të infektohet nga një agjent infektiv në kushte natyrore.

Host factor (Faktori i strehuesit)
Një faktor i brëndshëm (mosha, raca, seksi, sjellja etj) të cilët ndikojnë ekspozimin e individit, ndjeshmërinë ose përgjigjen ndaj një agjenti shkaktar.

Human capital (Kapitali njerëzor)
Investime ne kohe, përpjekjesh dhe parashë në edukim, trajnim ose shëndet për të përmirësuar produktivitetin ashtu si dhe investimet e kapitalit financiar.

Human resources (Burime njerëzore)
Njerëzit që punojnë në profesione të ndryshme në kujdesin shëndetësor

Hyperendemic disease (Sëmundje hiperendemike)
Një sëmundje që është e pranishme në mënyrë të qëndrueshme me një incidencë te lartë dhe /ose prevalencë të lartë.

I

I D A Shkurtim në anglisht për "International Development Association (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim).
Themeluar me 1960. Është një shoqatë e lidhur me Bankën Botërore. Ajo jep kredi më fleksibel se ato të një banke. Qendra është në Washington, D.C.

I L 0 Shkurtim në anglisht për. "International Labour Organisation" (Organizata Ndërkombëtare e Punës).
Themeluar me 1919. Qendra në Gjenevë. 150 vende anëtare. Lidhet me OKB-në 1946. Ndër të tjera merret me sigurinë në punë, punën e nënës dhe femijës dhe sigurinë sociale.

Immunization (Imunizim)
Procesi me anë të të cilit nje njeri apo një kafshe mbrohet kundër nje sëmundjeje. Ky term përdoret shpesh në vend te vaksinimit ose inokulimit.

Immunization status (Gjëndja imunitare)
Është krahasimi i vaksinimeve të bëra tek fëmija me ato të keshilluara në kalendarin e vaksinimit. Vlerësimi i një gjendje të tillë do të thotë që një femije ka bërë të gjitha vaksinat që keshillohen për moshën e tij dhe n.q.s jo, të përcaktohen cilat vaksina janë të nevojshme të bëhen.

Immunity (Imunitet)
Një rezistencë natyrore ose e fituar ndaj një semundje të caktuar. Imuniteti mund të jetë i pjesshëm ose i plotë, mund të zgjase për gjithe jetën ose mund të jetë i përkohshëm. Ka dy tipa te imunitetit, pasiv dhe aktiv. Imuniteti vërtetohet përmes pranisë së kundertrupave në gjak dhe zakonisht mund të percaktohet me teste laboratorike.

Immunosuppression (Frenimi i imunitetit)
Frenim i sistemit imun dhe aftësisë së tij për të luftuar infeksionin. Një frenim i tillë mund të ndodhë nga disa sëmundje si AIDS, linfoma ose nga disa medikamente siç janë disa prej atyre që trajtojnë kancerin.

Impact (Efekt, ndikim, impakt)
Efektet totale,të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të një programi, shërbimi ose institucioni mbi statusin shëndetësor dhe mbi zhvillimin e përgjithshëm shëndetësor dhe social-ekonomik.

Impairment (Prishje, dobësim)
Në konteksin e shëndetit nënkupton çdo humbje ose shmangie nga normaliteti të struktures apo funksioneve psikologjike, fiziologjike dhe anatomike

Implementation (Zbatim, vënie në jetë, implementim)
Kryerja e një projekti apo programi.
Përfshin jo vetëm punën në vetvete, por të gjitha aktivitetet mbështetese si përgatitjen e termave të referencës, sigurimin e fondeve, ngritjen e strukturës organizative, komunikimin dhe kryerjen e një projekti të evaluimit.

Incentives (Stimuj, incentive).
Në sistemin shëndetësor janë nxites që përdorin shpërblimin duke tentuar të inkurajojnë tipe të caktuara të veprimtarive.

Incidence (Incidencë)
Numri i rasteve të reja të sëmundjes që hasen në një popullate të caktuar brënda një periudhë të dhënë kohe, zakonisht në një vit.

Incidence rate (Shkalla e incidencës)
Një masë e frekuencës me të cilën një ngjarje si për shembull një rast sëmundje haset në një popullatë të caktuar gjatë një periudhe të caktuar kohe. Emëruesi është popullata në risk dhe numurues është numri i rasteve të reja që hasen gjatë periudhës së caktuar të kohës.

Incubacion (Inkubacion)
Një periudhë e ndryshimeve subklinike ose të padukshme që vijnë pas ekspozimit ndaj një agjenti infektiv dhe që mbaron me fillimin e shënjave klinike të sëmundjes infektive

Indicators (Tregues, indikatorë)
Variabla të identifikuar dhe të matshëmm, të cilët ndihmojnë për të treguar ndryshimet që lidhen në mënyrë direkte ose indirekte me qellimin, objektivat dhe shënjestrat.

Indirect transmission (Transmetim indirekt)
Një transmetim i një agjenti që mbartet nga rezervuari tek strehuesi i ndjeshëm, përmes grimcave të pezulluara në ajër ose përmes qenieve të gjalla që shërbejnë si vektorë ose atyre jo të gjalla që shërbejnë si mjete të trasportimit

Indirect costs (Kosto indirekte). Shih "Cost"

Infant (Foshnje)
Fëmija nga zero deri në moshën një vjeç

Infant feeding formulae (Formula te ushqyerjes së foshnjes)
Qumështra në gjendje pluhuri (te përqendruara) ose produkte të sojës që shiten si zevendesues të qumeshtit të gjirit. Ato përgatiten përpara përdorimit me ujë të zier të ftohur.

Infant mortality (Vdekshmëria foshnjore)
Vdekshmëria e foshnjeve nga 0-1 vjeç.

Infant mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë foshnjore)
Një raport që shpreh numrin e vdekjeve midis fëmijeve nën një vit gjatë një periudhe të caktuar kohe pjestuar me numrin e lindjeve të raportuar për atë periudhë kohe. Zakonisht shkalla e vdekshmërisë foshnjore shprehet për 1000 lindje të gjalla.

Infectivity (Infektivitet)
Mat proporcionin i personave që i ekspozohen një agjenti shkaktar dhe që infektohen nga një sëmundje infektive.

Inpatient (Pacient i brendshëm, i shtruar). Shih gjithashtu "Ambulatory care". Në dallim me "Outpatient"
Një pacient i cili pranohet zyrtarisht (ose i shtruar në spital) në një institucion për trajtim dhe ose për kujdes shëndetësor dhe që qendron minimalisht një nate në spital ose në një institucion tjetër që ofron kujdes për pacientë të brendshëm.

Përkufizim plotësues: Një pacient i cili ka kaluar përmes procedurës së plotë të pranimit dhe ka zënë një shtrat në një pavion me pacientë të brendshëm.

Input (Input). Shih gjithashtu "Health resources"
Një sasi e caktuar e matshme e burimeve, e caktuar për një proces.
Në punën kërkimore shëndetësore, imputet në prodhimin e kujdesit shëndetësor janë për shembull shtratet spitalore, mjeket, medikamentet etj
Përkufizim plotësues: I referohet përdorimit të burimeve në një proces prodhimi.

Insured (I siguruar). Shih "Beneficiaries"

Intangible costs (Kosto të paprekshme, të pakapshme). Shih "Costs"

Intensive care: Kujdesi shëndetësor qe kerkon vemendje shumë te madhe dhe kujdes e mbajtje nen kontroll te vazhdueshem. Reanimacion.(ne kuptimin e sherbimit)

Internal efficiency (Efiçience e brendshme). Shih "Efficiency"

Intersectoral action (Veprim ndërsektorial)
Veprim në të cilin sektori shëndetësor dhe sektorë të tjerë përkatës të ekonomisë bashkëpunojnë ose ndërveprojnë për të arritur qëllimet shëndetësore.
Sektor, në këtë kuptim, është sistemi i kujdesit shëndetësor dhe jo një nënsektor
(si kujdesi ambulator). Një tjetër sektor do të ishte për shembull sistemi arsimor.

Integrated model (Modeli i integruar). Në dallim me "Contract model"
Sigurim shëndetësor i detyrueshëm ose vullnetar ose një financim nga një palë e tretë në të cilin si sigurimi ashtu dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor ofrohet nga i njëjti institucion në një sistem të integruar në mënyrë vertikale.
Në këtë model mjeket paguhen në mënyrë tipike nga rroga dhe spitalet dhe fondet jepen nga buxheti global. Përfitimet i jepen pacienteve në natyre, shpesh falas. Versioni publik i këtij modeli përfshin financimin shtetëror dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe shpesh fondet sigurohen kryesisht nga taksat e përgjithshme.
Përkufizim plotësues: Termi përdoret për sistemin e financës së shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimit, në të cilin, si financimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore ofrohen nga i njëjti institucion, pa ndarje midis blerësve dhe ofruesve, pra ofruesit e kujdesit shëndetësor janë të punësuar direkt nga një palë e tretë paguese dhe nga pikëpamja menaxheriale janë përgjegjës ndaj një serie organizmash qeverisëse. Ky haset zakonisht në të ashtuquajturit shërbime shëndetësore kombëtare në sistemet e Beverixhit dhe Semashkos.

International Monetary Fund (Fondi Ndërkombëtar Monetar -F M N)
Themeluar me 1944. Promovon bashkëpunimin monetar dhe stabilizimin e valutave. Qendra në Uashington, D.C. Ka 151 vende anëtare.

Intervention (Ndërhyrje)
Një aktivitet ose një seri aktivitetesh që synojnë modifikimin e një procesi, ecurije veprimi ose një

sekuence ngjarjesh, në mënyrë që të ndryshojë një ose disa prej karakteristikave të tyre si rendimentin ose rezultatet e pritshme.

Incubation period (Periudhë e inkubacionit)
Është ajo periudhë kur mikroorganizmi ndodhet në trup, por nuk shkakton shënja të sëmundjes. Quhet shpesh edhe periudha e latencës.

Infection (Infeksion)
Prania e një shaktari brënda një strehuesi ku ai mund, por edhe nuk mund të shkaktojë sëmundje.

I N S T A T - Instituti i statistikës
Nën vartesinë e Keshillit të Ministrave. Realizon shërbimin statistikor në Republiken e Shqipërisë. Aktivietet aktuale përfshijnë statistikat për çmimet, ato demografike, të biznesit, tregtisë së jashtme e të brendëshme, statistika jetësore, statistika arsimore, shëndetësore, të punës etj.

Integrated Management of Childhood Illnesses, shkurt-IMCI (Menaxhimi i Integruar i Sëmundjeve të Femijërisë)
Një lloj strategjie që lejon trajtimin e menjëhërshëm në periferinë me ekstreme të sistemit të kujdesit shëndetësor të pesë shkaqeve me të zakonshme të vdekjeve tek mosha fëminore që janë, pneumonia, sëmundjet diareike, malaria, fruthi dhe keq-ushqyerja.

Intergovernamental organisation (Organizata ndërqeveritare)
Një organizatë e cila është themeluar mbi bazën e një marrëveshje ndërqeveritare. Për shembull OBSH, Keshilli i Evropës etj.

Investment for health (Investim për shëndetin)
I referohet burimeve të cilat i kushtohen qartë prodhimit dhe përmirësimit të shëndetit. Ato mund të investohen nga agjensi publike ose private si dhe nga individë apo grupe njerëzish.

L

Latency period (Periudha e latencës)
Një periudhë e ndryshimeve subklinike ose inaparente pas ekspozimit, që mbaron me fillimin e simptomave të sëmundjes kronike.

Legal drinking age (Mosha ligjore e pirjes)
Është ajo moshë poshtë të cilës ndalohet me ligj blerja e alkolit

Lehap (Shkurt ne anglisht për "Local Environemt and Health Action Plan-Plan Lokal i Veprimit për Mjedisin dhe Shendetin)
Perfaqeson shtrirjen ne nivelin lokal te Planit Kombetar te Veprimit për Mjedisin dhe Shendetin.

Licensing (Liçensim). Shih gjithashtu "Accreditation"
Vendosja e kufizimeve legale që përcakton se cilët individe ose institucione kanë të drejten të ofrojnë shërbime ose mallra (zakonisht bazohet në përmbushjen e kërkesave minimale)
Në dallim me akreditimin, i cili është vullnetar dhe kryesisht administrohet nga organizma joqeveritare. liçensimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor zakonisht është i detyrueshëm dhe i imponuar nga shteti.
Përkufizim plotësues: Liçensimi i cili përdor standarte, vendos nivele minimale, pra kërkesa që duhet të plotësohen për të caktuar një individ ose një institucion si të përshtatshëm për të ofruar një shërbim për publikun.

Licensing of the activities in the pharmaceutical sector (Liçensimi i veprimitarive në sektorin farmaceutik)
Pajisja me leje për ushtrimin e aktivitetit privat për import, eksport, shitje me shumicë dhe pakicë të barnave, materialeve mjekësore dhe aksesorëve, nga Komisioni Liçencave i Ministrisë së Shëndetësisë.

Lifestyle (Mënyra e jetesës)
Një mënyrë e përgjithshme e të jetuarit e bazuar në ndërlojën midis kushteve të jetesës në kuptimin e gjërë dhe menyrat idividuale të sjelljes të përcaktuara nga faktoret social-kulturore dhe karakteristikat personale.

Life expectancy (Jeta e pritshme)
Numri i viteve që pritet të jetojë mesatarisht një popullsi e dhënë.
Përllogaritet me mesataren e jetës, bazuar në shkallën aktuale të vdekshmërisë për të gjitha grup-moshat. Indikatorë të tjerë të jetës së pritshme janë jeta e pritshme në moshen 1,15, 45 dhe 65 vjeç.

Lifeskills (Aftësi, zotësi jetësore)
Janë ato zotësi personale sociale, njohëse dhe fizike që cilat i bëjnë njerëzit të aftë të kontrollojnë dhe drejtojnë jetën e tyre, dhe të zhvillojnë aftësinë për të jetuar me ndryshimet dhe për të sjellë ndryshime

List of essential drugs (Lista e medikamenteve esenciale)
Listë medikamentesh më të domosdoshëm për të arritur një nivel shëndetësor të arsyeshëm për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur. Hartuar për herë të parë në vitin 1977 nga OBSH-ja. Në atë kohë numëronte rreth 200 zëra. Sot rreth 300. Rishikohet çdo dy vjet

Long-term care (Kujdesi afatgjatë)
Kujdesi afatgjatë përfshin një seri të gjërë ndihmash me veprimtari ditore që individet me paaftësi kronike kanë nevojë për një periudhe të gjatë kohe.
Kujdesi shëndetësor parësor merret kryesisht me ruajtjen ose përmirësimin e aftësisë të së moshuarve me paaftësi për të bërë një jetë sa më të pavarur që të jetë e mundur. Ai përfshin gjithashtu nevojat sociale dhe mjedisore dhe prandaj është më i gjërë sesa modeli mjeksor që dominon kujdesin akut. Kryesisht ai është me teknollogji të ulet, megjithëse është bërë më i koklavitur, pasi tek ai po përfundojnë të moshuar me nevoja komplekse dhe që qëndrojnë në mjediset tradicionale të kujdesit afatgjatë përfshirë edhe shtëpite. Shërbimet dhe strehimi janë që të dy thelbesore në zhvillimin e politikës dhe sistemeve të kujdesit shëndetësor afatgjatë.
Përkufizim plotësues: Shtëpi të përkujdesjes, infermieret vizituesë shtëpijake dhe shërbime të tjera që i ofrohen të sëmurëve kronikë ose personave me paaftësi.

Longitudinal study (Studim longitudinal)
Është ai studim që bëhet në kohë, pra jo në një moment të caktuar por në vazhdimësi.

M

Malnutrition (Kequshqyerje)
Çdo çrregullim i ushqyerjes. Mund të vijë nga ushqyerja e pakët, por edhe e tepërt dhe e pabalancuar.

Managed Care (Kujdesi i menaxhuar)
Përdorimi i një menaxheri në kontrollin dhe shfrytëzimin e shërbimeve mjekësore dhe kontrollin e shpenzimeve.
Shpesh bashkë me institucionet shëndetësore, forma të tjera të kujdesit të menaxhuar përfshijnë kontrollin nga koleget, procedurat e miratuara që më parë në kirurgji, menaxhimin e rastit për të sëmuret kronike, formulare që kufizojnë rimbursimin farmaceutik në një liste të miratuar, dhe oferta të tjera të kontraktuara. Institucionet e kujdesit të menaxhuar e vendosin theksin në krijimin e strukturave që rrisin kontrollin dhe menaxhimin e financimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Managed Health Care (Kujdesi shëndetësor i menaxhuar)
Një sistem i ofrimit të kujdesit shëndetësor që ndikon shfrytezimin dhe koston e sherbimeve dhe që mat punën e kryer. Qellimi i tij është një sistem që ofron vlera duke i dhënë njerëzve mundësinë për kujdes shëndetësor cileësor dhe në një mënyre kosto-efektive

Managed competition (Konkurence e menaxhuar). Shih gjithashtu "Competition"
Rregullim shtetëror i tregut të kujdesit shëndetësor, i cili përdor konkurencën si mjet për të arritur objektivat e efiçiencës brënda kuadrit të ndërhyrjeve shtetërore, i hartuar për të arritur objektiva politike si ekuiteti.

Management (Menaxhim)
Masat e marra për planifikimin, organizimin, veprimin dhe vlerësimin e të gjithë elementeve të shumtë të një sistemi dhe personelit të përfshire në detyrën e menaxhimit.

Marginal benefit (Përfitim shtesë, skajor, marxhinal)
Një përfitim shtesë që merret duke konsumuar njësinë e fundit (atë të radhës) të një malli.
Shpesh, përfitimi marxhinal është më i ulet sesa përfitimi mesatar, për shembull dita e fundit e qendrimit në spital nuk kontribuon në rezultat aq sa një ditë tjetër gjatë këtij qendrimi. Megjithatë ngandonjëherë për shembull, nëse nevojitet një shkallë e caktuar e imunizmit në komunitet, përfitimi marxhinal është më i madh sesa përfitimi mesatar.
Përkufizim plotësues: Përfitimi shtesë (për shembull në njësi të rezultatit shëndetësor) që prodhohet nga shtimi i një burimi (për shembull një ndërhyrje në kujdesin shëndetësor)

Marginal cost (Kosto marxhinale). Shih "Cost"

Market mechanism (Mekanizmi i tregut)
Ndërveprimi i blerësve dhe shitësve në një treg dhe në ekonomite e përziera, i cili përcakton natyrën dhe volumin e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, dhe shpërndarjen e tyre

Market failure (Dështim i tregut)
Një situatë në të cilën ekonomia e tregut deshton në arritjen e efiçiencës ekonomike.
Përkufizim plotësues: Paaftësia e tregut për të arriur në një ekuilibër efiçient të llogjikshëm në disa kushte të caktuara,si kryesisht ekzistenca e mallrave publike, eksternaliteteve, mungesa e të drejtave të qarta ndaj pronës, paaftësia e disa konsumatoreve për të vepruar në interesin e tyre më të mirë,

monopoli natyror si pasojë e uljes konstante të mesatares së kostos së prodhimit, transaksione të tepëruara të kostos ose asimetria e informacionit.

Maternal mortality (Vdekshmeri amëtare)
Një tregues qe mat rrezikun e vdekjes së një nëne nga shkaqe që kanë të bëjnë me barrën. Një vdekje amëtare është vdekja e një nëne kur ajo është shtatëzane ose brënda 42 ditëve të para pas lindjes.

Measles complications (Komplikacionet e fruthit)
Komplikacionet e fruthit janë gjëndje ose infeksione që ndeshen gjatë ose pas kalimit të fruthit. Disa nga komplikacionet e fruthit janë: diarrea, pneumonia, stridori, ulçerat e gojës, infeksioni i syrit. Komplikacion me i rralle është encefaliti (inflamacion i trurit)

Measure of association (Masa e asocijimit)
Një lidhje e përcaktueshme nga pikëpamja sasiore midis ekspozimit dhe sëmundjes. Përfshin riskun relativ, raportin e shkallës.

Medical surveillance (Survejanca mjekësore)
Monitorimi i individeve potencialisht të ekspozuar për të zbuluar simptomat e hershme të sëmundjes.

Medical audit (Kontrolli i rezultateve mjekësore). Shih "Clinical audit"

Medical doctor (MD) (Doktor në mjekësi). Shih "Physician"

Medical savings account (Kontoja e kursimeve mjekësore)
Është një lloj kontoje që lejon ose mandaton njerëzit të vendosin pará në konto kursimi (pa taksë) për ti përdorur vetëm për shpenzime mjekësore.

Members (Anëtare). Shih "Beneficiaries"

Mental health (Shëndet mendor)
Është aftësia për të menduar dhe mësuar si dhe aftësia e një individi për të kuptuar dhe jetuar me emocionet e veta dhe reagimet e të tjerëve. Shendeti mendor është një komponent i shendetit i lidhur ngushtë me aspektet e tjera te shëndetit. Shëndeti dhe shëndeti mendor janë produkte te një serie dimensionesh te ndërlidhura, përfshirë dimensionin fizik, emocional, social, kulturor dhe shpirtëror.

Merit good (Mallra meritë). Shih "Good"

Military Hospital of Tirana (Spitali Ushtarak i Tiranës)
Ka 412 shtretër. Është nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Shërben edhe si qendër kombëtare e traumatologjise dhe ortopedisë.

Mixed formula (Formula e përzier)
Shpesh është pagimi i specialistëve, i bazuar mbi një përzierje metodash (për shembull pagesë për frymë plus tarifën për shërbim për disa shërbime të caktuara). Po ashtu ketu mund të futen si plotësuesë edhe pagesa me bonuse ose shënjestra, që përdoren si stimuj në rast se arrihen disa objektiva të caktuara.

Monitoring (Monitorim)
Mbikqyrja e vazhdueshme e një aktiviteti për të ndihmuar në supervizionin e tij dhe për të parë nëse ai po ecën sipas planit.
Përkufizim plotësues: Monitorimi përfshin përcaktimin e metodave për të matur veprimtarinë, përdorimin e burimeve dhe përgjigjen sipas kritereve të caktuara.

Moral hazard (Rrezik moral)
Mundesia e konsumatoreve ose ofruesve që të shfrytezojnë jo sipas rregullave një sistem të përfitimeve, në dëm ose dizavantazh të konsumatoreve të tjere, ofruesve ose komunitetit financiar, pa pësuar pasojat financiare.
Një term i sigurimeve shëndetësore. Aty ku shërbimet nuk paguhen direkt nga individet, ata mund të kenë rrezik ose të veprojnë në një mënyrë, e cila rrit kërkesën për shërbime shëndetësore. Është në interes të siguruesit të krijojë dezincentive ndaj të tilla sjelljeve (si bashekpagesën ose premiume mbi bazën e riskut)

Morbidity cost (Kostoja e sëmundshmërisë). Shih "Cost"

Morbidity rate (Shkalla e sëmundshmërisë)
Shkallë e sëmundjes ose paaftësisë, zakonisht e shprehur për 1000 njerëz.

Mortality cost (Kostoja e vdekshmërisë).Shih "Cost"

Mopping up (Krehje)
Vaksinimi ndaj asaj pjese të popullatës që konsiderohet me risk të lartë për të marrë sëmundjen përkatëse. Për shembull vaksinimi shtëpi me shtëpi për polion praktikohet pas Ditëve Kombëtare të Imunizimit

Morbidity (Morbiditet, sëmundshmëri)
Çdo shmangie, subjektive apo objektive nga një gjendje fiziollogjike apo psikologjike.

Mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë)
Masa e shpeshtësisë së hasjes së vdekjes në një popullsi të caktuar gjatë një periudhe të kohe të caktuar.

Multiple infection (Infeksion i shumfishtë)
Një infeksion ku individi është i infektuar me më tepër së një lloj specie.

Mutuelles/Mutualités. Shih "Sickness funds"

N

National Agency of Environement (Agjensia Kombëtare e Mjedisit)
Pasardhësja e Komitetit të Mbrojtjes së Mjedisit. Deri në 1992 në vartësi të Këshillit të Ministrave. Nga 1992 deri me korrik 1998 brenda Ministrisë së Shëndetesisë dhe Mjedisit. Nga korriku 1998 përsëri në vartësi të Këshillit të Ministrave. Duke filluar nga viti 2001 ajo shndërrohet në Ministri të Mjedisit

National Drug Policy (Politikë Kombëtare e Barnave)
Futja, disponueshmeria, cilësia e mirë dhe përdorimi racional i barnave nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Listes së Barnave Thelbësore, Formularit Kombëtar të Barnave, Listës së Barnave Kryesore që Rimbursohen dhe regjistrimit të barnave.

National Formulary of Drugs (Formulari Kombëtar i Barnave)
Udhëzues mjekësor i miratuar nga Ministria e Shëndetesisë, në dispozicion të mjekëve dhe farmacistëve, që kontribuon në përdorimin racional të barnave.

National Health Service-NHS (Shërbimi Kombëtar Shëndetësor). Shih "Beveridge system"

National health accounts (Llogaria kombëtare shëndetësore). Shih edhe "Health expenditure"
Informacion, zakonisht në formën e indikatorëve, që një vend mund të grumbullojë lidhur me shpenzimet shëndetësore.
Indikatorët mund të përfshijnë shpenzimet totale shëndetësore, shpenzimet publike, shpenzimet private, shpenzimet nga xhepi, ato nga taksat dhe shpenzime të tjera publike, shpenzimet për sigurimet sociale, shpenzimet publike për shëndetin.

National immunisation days (Ditët kombëtare të imunizimit, vaksinimit)
Nënkuptojnë një fushatë masive vaksinimi në shkallë kombëtare në ditë të caktuara për sigurimin e një mbulese vaksinale optimale. Tipike kanë qënë ditët kombëtare të imunizimit kundër poliomielitit të zbatuara me sukses edhe në Shqipëri në vitet 1996,1997, 1998, pra është një vaksinim plus atij të rutinës (kalendarit të vaksinimit).

National level planning (Planifikimi në nivel kombëtar)
Planifikimi i vazhdueshëm, i gjërë dhe i koordinuar për alokimin ose investimet e burimeve të vendit në mënyrë të tillë, që të arrijë ku duhet dhe nivelin e dëshiruar ekonomik dhe zhvillimin social. Planifikimi në nivel kombëtar përfshin integrimin e nevojave dhe qëllimeve të kujdesit shëndetësor, arsimit, bujqësisë, sigurisë publike, transportit, ekollogjisë dhe agjensive të tjera që lidhen me të.

National Programe on Aids (Programi Kombëtar për AIDS)
Fillon punë në Shqipëri në gusht 1987 brenda Ministrisë së Shëndetësisë, në Drjetorinë e Higjenës dhe Epidemiologiisë me ndihmë direkte të OBSH-së. Programi del me vete, jashtë Ministrisë por në vartësi të saj në korrik 1991.

National Public Health Conference (Konferenca Kombëtare e Shëndetit Publik)
Konferenca më e madhe e shëndetit publik e mbajtur ndonjëherë në Shqipëri.
(Tiranë 14-16 Janar 1999). Shërbeu si bazë për hartimin e Dokumentit të Politikës dhe Strategjisë së Shëndetësisë

Natural history of disease (Historia natyrore e sëmundjes)
Ecuria kohore e sëmundjes nga fillimi deri në mbarim

N E A P
Shkurt në anglisht për "National Environmental Action Plan" (Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin). Për herë te parë ky plan është përpiluar nga Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Bankën Botërore në 1993 dhe miratuar nga Qeveria në janar 1994.

Necessary cause (Shkak i nevojshëm)
Një faktor shkaktar prania e të cilit duhet, që të ndodhë efekti (sëmundja)

Need (Nevojë)
Ajo çka një person kërkon nga pikëpamja e kujdesit shëndetësor

Negative list (Lista negative)
Lista e atyre medikamenteve që nuk rimbursohen

N E H A P Shkurt në anglisht për „National Environmental and Health Action Plan"(Plani Kombëtar për Mjedisin dhe Shëndetin PKVMSH)
Nismën e ka në qershor të vitit 1994 në Konferencën e Helsinkit, ku Ministrat e Mjedisit dhe Shëndetit të Rajonit Evropian u angazhuan të përpilojnë Planet Kombëtare të Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin, duke patur si qellim të orientonin aktivitetet e shëndetit mjedisor brenda vendeve, pa interferuar me prioritetet që çdo vend mund të kishte vendosur dhe të sygjeronin aksionet e bashkërenduara nga OBSH dhe të gjitha organizatat e tjera, me përgjegjësinë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mirëqenies dhe cilësisë së mjedisit. Vendi yne filloi përgatitjen e PKVMSH në fillim të vitit 1997. Përgatitja e tij u realizua nga grupi teknik i punës për këtë qellim, i drejtuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me OBSH-në. Ai u miratua në qershor 1999.

Neonatal mortality (Vdekshmëria neonatale)
Vdekja e foshnjeve me moshë nën 28 ditë.

Neonatal mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë neonatale)
Një shkallë që shpreh numrin e vdekjeve midis fëmijeve nga lindja e sipër pa përfshhirë ditën e 28 të jetës, pjestuar me numrin e lindjeve të gjalla të raportuar për të njëjtën periudhë kohe. Zakonisht kjo shprehet për 1000 lindje të gjalla.

Network (Rrjet)
Një grupim individësh, organizatash dhe agjensishë, i organizuar mbi një bazë jo hierarkike rreth disa çështjeve të interesit të përbashkët, të cilat ndiqen në mënyrë shumë aktive dhe sistemike, mbi bazën e një angazhimi dhe besimi.

Nominal scale (Shkalla nominale)
Klasifikim në kategori jo të renditura për shembull raca, feja,vendi i lindjes janë atribute të matshme individuale thjeshtë nominale pasi nuk është se midis tyre ka një lidhje apo renditje të brendëshme.

Non-governametal organisation (Organizata joqeveritare)
Shkurt në anglisht si NGO(en-xhi-ou). Shumë të pranishme në Shqipëri. Janë vendase dhe të huaja. Nga vendaset me të fuqishmet janë ato që merren me çështjet e grave dhe ato të shëndetit. Nga të huajat mund të përmenden të tilla si CARITAS, PSI, MSI, SEATS, Merlin,Feed the Children, OXFAM, Sorros, SNV, MSF, EEP.

Non-recurrent expenditure (Shpenzim jo-rrjedhes).Shih "Capital expenditure"

Normal curve (Kurbe normale)
Është një kurbë në formë këmbane që rezulton kur ndërtohet grafiku i një shpërndarje normale.

Normal distribution (Shpërdarje normale)
Grumbullimi simetrik i vlerave rreth një vendosje qëndrore.

Notifiable diseases:
Semundje qe duhet denancuar

Nurse (Infermiere)
Një person që ka përfunduar një program të edukimit bazë infermieristik dhe është kualifikuar dhe autorizuar në vendin e tij për të zbatuar në praktikë infermieristikën në të gjitha mjediset, për promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjes, kujdesin për të sëmurin dhe rehabilitimin e tij. *Përkufizim plotësues*: Të dhënat lidhur me numrin e infermiereve duhet të trajtohen me kujdes. Si në burimet kombëtare ashtu dhe në ato ndërkombëtare, shpesh është e paqarte nëse shifrat (kur janë të disponueshme) i referohen të gjitha infermiereve të kualifikuara, të regjistruara ose atyre që punojnë aktualisht.

Nursing (Kujdesi infermieristik)
Në kuptimin më të gjërë nënkupton ofrimin e kujdesit infermieristik për individë ,familje apo komunitete për të rikthyer shëndetin apo për shërbime parandaluese. Një shërbim i tillë mund të ofrohet që nga ndihmës-infermierja deri tek infermierja dhe infermierja-mami profesioniste.

O

Objective (Objektiv). Shih gjithashtu "Goal"
Një gjendje e matshme ose një nivel i arritjes në çdo stad të përparimit drej qellimit.
Objektivat kanë edhe një kuader kohor përkatës, brenda të cilit duhet të plotësohen .
Përkufizim plotësues: Rezultati përfundimtar që një program, projekt ose një institucion kërkon të arrijë.

Observational study (Studim vëzhgues)
Një studim epidemiologjik në situata ku natyres i lihet të ndjekë ecurinë e saj. Ndryshimet ose diferencat në një karakteristike studiohen pa ndërhyrjen e studiuesit

Occupancy rate (Shkalla e shfrytëzimit)
Përqindja e shtretërve spitalorë të zënë në një periudhe të caktuar kohe (ose një periudhë specifike) Nëse shkalla mesatare e shfrytëzimit nuk dihet, ajo mund të përllogaritet si më poshtë: pranimi për frymë herë mesataren e kohëqendrimit, pjestuar për shtratet spitalore për frymë herë 365 .

OECD-Organisation for Economic Cooperation and Development (Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik)
Organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1961 për të stimuluar progresin ekonomik dhe tregtinë botërore.

Open enrolment (Rekrutim i hapur)
Një periudhë gjatë së cilës një siguruesi mund ti kërkohet të pranojë çdo anëtar të ri ose abonent, pavaresisht nga risku i tyre.Rekrutimi i hapur i pengon kompanite e sigurimit nga "mbledhja e ajkes", pra nga seleksionimi i pacientëve më të shëndetshëm, në mënyrë që të nxjerrin përfitim më të madh.
Përkufizim plotësues: Një periudhë gjatë së cilës anëtaret kanë mundësi të zgjedhin një plan shëndetësor alternativ që u ofrohet.

Opportunistic Infections (Infeksione oportuniste)
Janë infeksione që shaktohet nga agjentë infektive në kushte të dobësimit të sistemit imun të organizmit siç ndodh në rastin e AIDS-it. Tek njeriu i shëndoshë ato nuk shkaktojnë sëmundje, ndërsa tek ai me AIDS ato kërcënojnë jetën dhe çojnë në vdekje. Pneumonia nga *Pneumocisti carinii*, është një nga infeksionet më të zakonshme dhe më vdekjeprurëse oportuniste që shoqërojnë HIV-in.

Opportunity cost (Kostoja oportune) Shih "Cost"

Optimal health (Shëndet optimal)
Barazpesha midis shëndetit fizik,emocional, social, shpirtëror dhe intelektual

Opting-in (Futje, të pranuarit për t'iu bashkuar diçkaje)
Procesi kur njerëzit zgjedhin të marrin pjesë në një plan shëndetësor (zakonisht publik) të cilit nuk do ti përkisnin pa vendimin e tyre aktiv për të bërë një gjë të tillë.

Opting-out (Largim, zgjedhja e opsionit për t'u larguar nga diçka)
Procesi kur njerëzit zgjedhin të mos marrin pjesë në një plan shëndetësor (zakonisht publik), i cili do tu caktohej nëse ata nuk do të bënin një zgjedhje aktive.

Order of Physicians (Urdhëri i mjekëve)
I krijuar në in 1993, është përgjegjës për regjistrimin dhe standartet profesionale të mjekëve.

Ordinal scale (Shkallë rendore)
Klasifikimi në kategori të renditura nga pikëpamja cilësore, për shembull klasa sociale (I,II,III),

Outbreak (Shpërthim)
Përdoret shpesh si sinonim i epidemisë. Ndonjëherë preferohet sepse nuk krijon sencacionin e fjalës epidemi. Gjithashtu përdoret në vend të një epidemie të lokalizuar

Outcome (Rezultat). Shih gjithashtu "Clinical/ Economic outcome" dhe "Output"
Një ndryshim i një situate, që vjen pas një veprimi
Përkufizim plotësues: I referohet një rezultati përfundimtar të një procesi prodhimi ose aktiviteti për shembull një shëndeti më të mrë.

Outcomes research (Puna kërkimore lidhur me rezultatet)
Vlerëson impaktin e kujdesit shëndetësor në rezultatet shëndetësore për pacientët dhe popullatën. Ajo gjithashtu mund të përfshijë vlerësimin e impakteve ekonomike që lidhen me rezultatet shëndetësore siç janë kosto-efektiviteti dhe dobia e kostos. Studimi i rezultateve e vendos theksin mbi vlerësimet e problemeve shëndetësore (ose sëmundjen) të kujdesit shëndetësor të ofruar në përgjithësi në mjedise reale, në ekipet multidisiplinare dhe një seri të gjërë rezultatesh përfshirë vdekshmërinë, sëmundshmërinë, statusin funksional, mirëqënien mendore dhe aspekte të tjera që lidhen me cilesinë e jetës.

Out-of-pocket expenditure (Shpenzimi nga xhepi)
Veçanerisht në lidhje me Kontabilitetin Kombëtar Shëndetësor. është shuma e të gjitha pagesave nga xhepi të bëra nga individët.
Krahas sigurimit vullnetar privat, shpenzimi nga xhepi është komponenti madhor i shpenzimit shëndetësor privat.

Out-of-pocket payments (Pagesa nga xhepi). Shih "User charges"
Këto pagesa përfshijnë ndarjen e kostos me të tjerë si dhe shpenzimet private për shërbime që nuk mbulohen nga planet respektive shëndetësore
Përkufizim plotësues: Pagesë e bëre nga konsumatori i shërbimeve shëndetësore drejtpërsedrejt tek ofruesi në kohën kur e merr shërbimin. Pagesa që bëhen drejtpërsëdrejti nga pacienti. Ato përfshijnë ndarjen e shpenzimeve (dhe tarifën e paguesit) dhe pagesat jo zyrtare të bera ndaj ofruesve të shërbimit shëndetësor.

Outpatient (Pacient i jashtëm, ambulator), Në dallim me "Inpatient"
Pacient të cilit i ofrohen shërbime mjekësore dhe paramjekësore duke mos qënë i shtruar zyrtarisht në një institucion (klinikë private, spital me qendër për paciente ambulatorë ose ambulanca) dhe që nuk qëndron gjatë natës.
Përfshin pacientin i cili shkon në një spital për trajtim ose konsultë, por që nuk qëndron aty gjatë natës.
Përkufizim plotësues: Pacient të cilit i ofrohen shërbime në një klinike të një mjeku ose mjedise të tjera ambulatore

Outsource: Eshte një praktikë kur një institucion, për shembull një spital kontrakton një kompani tjetër për të ofruar shërbime ose produkte që po të bëheshin nga vetë institucioni do të ishin shumë të kushtueshme, të ndërlikuara dhe që do të hanin kohë për institucionin. (Përkthimi fjalë për fjalë nënkupton nxjerrjen e burimeve të tua jashtë)

Output (Autput). Shih gjithashtu "Outcome"
Rezultati i një procesi.
Përkufizim plotësues: I referohet produktit ose shërbimit imediat që vjen nga një proces ose veprimtari produktive, për shembull rezultatet e një procedure mjekësore.

Over-the-Counter Drug (Bar mbi banak)
Medikament që jepet pa recetë
Një bar që nuk ka nevojë për recetë sipas ligjit përkates të shtetit

P

Pandemic (Pandemi)
Sëmundje ngjitesë që dominon në një zonë shumë të gjërë gjeografike (për shembull AIDS-i është një pandemi)

Paramedical staff (Stafi paramjekësor). Shih gjithashtu "Human resources"
Personel që përfshin të gjitha llojet e profesioneve që lidhen me mjekësinë, si personeli në fushën e infermieristikës, mamisë, higjenës, higjenës së gojës, farmacisë, fizioterapisë, mjekësisë laboratorike, ushtrimeve terapeutike etj.
Përkufizim plotësues: Staf profesional i cili u jep mbështetje direkte mjekëve në punën e tyre ose në trajtimin e sëmundjes. Ai përfshin fizioterapistët dhe radiologët.

Parasite (Parazit)
Një organizëm që jeton brenda ose mbi një organizëm tjetër të cilit i merr ushqimin. Një parazit nuk mund të jetojë në mënyrë të pavaruar. Infeksionet nga parazitet përfshijnë protozoaret (p.sh malarien), helmintët (p.sh askaridin) dhe arthopodët

Pathogen (Patogjen)
Një substancë ose organizëm që është i aftë të shkaktojë sëmundje.

Pathogenesis (Patogjenezë)
Origjina dhe zhvillimi i sëmundjes

Passive immunity (Imunitet pasiv)
Imuniteti që i jepet përmes kundëtrupave të prodhuar në një strehues tjetër dhe që merren në mënyrë natyrore nga femija prej nënes së tij ose në mënyrë artificiale përmes administrimit të një preparati që përmban kundërtrupa (antiserum ose imunoglobulinë)

Patient (Pacient)
Një person në kontakt me sistemin shëndetësor, që kërkon vëmendje për një gjendje shëndetësore.

Patient-centred care (Kujdes shëndetësor që vë në qendër pacientin)
Një mënyrë e të vepruarit që me vetëdije zbaton një perspektivë të pacientit.
Kjo perspektivë mund të karakterizohet si ajo që merr në konsideratë respektin për vlerat, parapëlqimet, dhe nevojat e shprehuara nga pacienti lidhur me koordinimin dhe integrimin e kujdesit shëndetësor, informacionin, komunikimin dhe edukimin, komfortin fizik, mbështetjen emocionale dhe lehtësimin e frikës dhe ankthit, përfshirjen e familjes dhe miqëve, tranzicionin dhe vazhdimësinë.

Patients' rights (Të drejtat e pacientit).
Një seri të drejtash, përgjegjësishë dhe detyrash, nën të cilat një individ kërkon dhe merr shërbime të kujdesit shëndetësor.Meqë të drejtat e pacientit shpesh nuk janë të qarta, përmbajtja e tyre ndryshon nga vend në tjetrin si dhe me kalimn e kohës.

Pathogenicity (Patogjenicitet)
Proporcioni i personave të infektuar pas ekspozimit ndaj një agjenti shkaktar, të cilët pastaj zhvillojnë sëmundjen klinike.

Payment (Pagesë). Shih gjithashtu "Prospective payment" dhe "Retrospective payment"
Alokimi i burimeve (zakonisht pará) për institucionet dhe individet e sektorit shëndetësor, në këmbim të një pune (për shembull për ofrimin i shërbimeve, menaxhimin e institucionit)
Pagesa përfshin si dhënien e fondeve ashtu dhe shpërblimin. Format e pagimit përfshijnë buxhetin, pagesën për frymë, pagesën mbi bazë rasti, pagesën tarifë për shërbim,pagesën sipas ditëve dhe rrogen

Payroll tax (Taksa e pages)
Një taksë që pagohet mbi bazën e pagës Ndonjëherë përdoret në mënyrë jo korrekte, duke e ngatëruar me kontributin, por duhet të rezervohet për situata në të cilat pjesa e financimit e punëdhënesit bazohet thjeshtë në pagën (dhe jo për të paguar një pjesë të kontributeve në emër të të punësuarit, e cila mund të variojë sipas shoqërisë së sigurimeve, tavanit të të ardhurave etj)

Peer Review (Kontroll simotër, rishikim simoter, rishikim prej të njëjtit rang)
Është një mekanizëm që siguron cilësinë e kujdesit shëndetësor brenda bashkësisë shëndetësore. Ky kontroll i sigurisë kryhet nga specialistë të kujdesit shëndetësor (simotrat) për të siguruar se kujdesi shëndetësor i ofruar dhe shërbimet e përdorura janë siç duhet. Ai mund të përdoret gjithashtu për të identifikuar mashtrimet dhe abuzime të tjera të sistemit të pagesës në kujdesin shëndetësor

Per-diem charge/fee/payment (Pagesë,taksë,tarifë mbi bazë ditore)
Pagesë për shërbime mbi bazë dite, zakonisht për trajtimin e pacientëve të shtruar.
Tarifat mbi bazë ditore mbulojnë të gjitha shërbimet dhe shpenzimet për pacient në ditë dhe nuk ndryshojnë sipas trajtimit.
Përkufizim plotësues: Kur pagues të palës së tretë paguajnë spitalet mbi një bazë ditore.

Perfect competition (Konkurence e përkryer) Shih "Competition"

Perinatal mortality (Vdekshmeria perinatale)
Vdekjet fetale të vonshme (pas javës së 28 të barrës) plus vdekjet në javën e parë pas lindjes.

Perinatal transmission (Transmetimi perinatal)
Është transmetimi i një shkatari nga nëna tek fëmija gjatë lindjes

Period prevalence (Prevalenca periudhë)
Numri i rasteve të sëmundjes të pranishme gjatë një periudhe kohe

Personal health care (Shërbime shëndetësore personale)
Janë ato shërbime shëndetësore që kanë të bëjnë me personin, në dallim nga ato që kanë të bëjnë me një bashkësi njerëzish

P H A R E - Shkurt në anglisht për " Poland Hungary Rehabilitation Economy".
Program i Bashkimit Evropian në mbështejtje të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Programi në Shqipëri ka filluar në qershor 1992, megjithëse zyra në Tiranë është hapur vetëm në tetor 1993. Fillon aktivitetin në Shqipëri në fushën e shëndetesisë në prill 1994 duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor, në mbështetje të reformës për spitalet, përmirësimin e sektorit farmaceutik dhe në kuadrin legjislativ të sektorit shëndetësor.

Pharmaco-vigilance (Farmako-vigjilencë)
Studimet sistematike të kontrolluara (të dokumentuara), të lidhura me përfitimet dhe rreziqet që vijnë nga përdorimi i barnave që qarkullojnë në tregun farmaceutik.

PHC.Shih "Primary Health Care"

Physician (Mjek)
Një person që ka kryer studimet në mjekësi në nivel universitar. Që të liçensohet legalisht për punë të pavarur në mjekësi ai ose ajo në shumicën e rasteve i nënshtrohet trajnimit pas-universitar në një spital.I quajtur gjithashtu doktor. Të dhenat lidhur me numrin e mjekeve, si nga burimet kombëtare ashtu dhe nga ato ndërkombëtare duhen të trajtohen me kujdes. Shpesh është e paqartë nëse shifrat (kur janë të disponueshme) i referohen mjekëve të kualifikuar, të regjistruar ose atyre që punojnë aktualisht.

Planning (Planifikim)
Një proces i organizimit të vendimeve dhe veprimeve për të arritur qëllime të caktuara brenda një politike të caktuar.

P M U - Shkurt në anglisht për "Programme Management Unit" (Njësi të menaxhimit të programeve)

***Pneumocystis carinii* pneumonia (Pneumoni nga *Pneumocystic carini*)**
Një infeksion i mushkërive që shkakton numrin më të madh të vdekjeve tek njerëzit të cilët janë HIV pozitiv.

Point prevalence (Prevalencë pikë)
Numri i të sëmureve nga një sëmundje e caktuar në një moment të caktuar kohe

Policy (Politikë)
Një marrëveshje ose konsensus midis partnerëve përkatës për çështje të cilat duhet të trajtohen dhe mbi metodat ose strategjite se si duhen trajtuar ato.

Pollution (Ndotje)
Përndryshim i drejtpërdrejtë a i tërthortë i vetive fizike, kimike, termike, biologjike ose radioaktive i çdo pjese të mjedisit, në masë të tillë sa që krijon rrezik potencial për shëndetin, sigurinë ose mirëqënien e specieve të gjalla.

"Polluter pays" principle (Parimi "Ai që bën ndotjen paguan")
Është një parim i përfshirë në ligjet e disa vendeve se ata prodhues të cilët janë përgjegjes për ndotjen duhet të paguajnë kompensimin për dëmin dhe koston e pastrimit nga ndotësit.

Polyclinic (Poliklinikë)
Një lloj ofruesi i shërbimit shëndetësor që ofron kujdes shëndetësor ambulator për më tepër se një specialitet shërbimesh.

Population (Popullsi)
Numri total i banorëve në një zone të caktuar ose në një vend të caktuar.

Population medicine (Mjekësi e popullsisë)
Analizë dhe vlerësim i kujdesit shëndetësor mbi bazën e kumunitetit ose grupit, sesa mbi bazën e individit. Ndërtimi i një sistemi që ka si objektiv ata që janë në nevojë më të madhe, duke pranuar edhe humbje në kurriz të përmirësimit të shëndetit mesatar, sesa përpjekja maksimale për individë të caktuar.

Position paper (Dokumenti i pozicionimit)
Është një dokument që shpreh pozicionimin e Ministrisë së Shëndetesisë lidhur me reformën e sistemit shëndetësor. Është hartuar në shtator 1999 dhe ishte një pararendës i dokumentit të strategjisë shëndetësore

Positive list (Listë pozitive)
Lista e atyre medikamenteve që rimbursohen

Postneonatal mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë postneonatale)
Një raport që shpreh numrin e vdekjeve midis fëmijeve nga dita e 28 e sipër por pa e përfshirë vitin gjatë një periudhe të caktuar kohe, pjestuar me numrin e lindjeve të gjalla të raportuar gjatë të njëjtës periudhe kohore. Zakonisht shprehet për 1000 lindje të gjalla.

Potential years of life lost (Vite potenciale të jetës së humbur)
Masë e viteve të humbur të jetës si pasojë e vdekjes së parakoheshme.
Vdekja premature i referohet normalisht moshës nga 70 e poshtë (në Evropë)

Practice: Klinike

Pre-existing condition (Gjendje para-ekzistuese). Shih gjithashtu dhe "Adverse selection"
Një sigurim shëndetësor mund të specifikojë se ai nuk do të marrë parasysh problemet tashmë të diagnostikuara ose që ndodhen nën trajtim, përpara se të blihet polica, që njihet me emrin gjendje paraekzistuese.
Përkufizim plotësues: Një gjendje fizike që ekzistonte përpara nxjerrjes së policës së sigurimit të këtij apo atij personi ose planit të rekrutimit, i cili mund ose mund të mos e kufizojë kontratën për mbulesën ose për përfitimet.

Premium (Premium,prim)
Një pagesë njeshe për sigurimin vullnetar.
Premiumet mund të diferencohen sipas moshës (në momentin e hyrjes në skeme), seksit dhe sëmundjeve para-ekzistuesë të personit të siguruar, të kalkuluara mbi vlerën prezente të një kostoje të pritshme, të cilen mund të shkaktojë një person i siguruar ose mbi bazë komuniteti.

Prescription (Përshkrim)
Dhënie, shkruajte e një recete

Prescription fraud (Mashtrimi me recetat)
Bashkëpunimi mjek i pegjithshëm me farmacistin për të bërë receta jo të ndershme

Price (Çmim)
Sasia e parave me të cilat blihet ose shitet diçka.
Çmimet në kujdesin shëndetësor mund të ndryshojnë sipas kostos dhe tarifave.
Përkufizim plotësues: Çmimet e administruara janë çmime të cilat përcaktohen nga një agjensi administrative sesa të vendosura në treg.

Primary health care (Kujdesi shëndetësor parësor). Shih gjithashtu dhe "Secondary/Tertiary health care"
Niveli i parë i kontaktit me njerëzit, që vepron për të përmirësuar shëndetin e komunitetit.
Në një sistem me portjer, të gjitha konsultimet fillestare (jo emergjente) me doktoret, infermieret ose stafin tjetër shëndetësor, quhen kujdesi shëndetësor parësor, në dallim me kujdesin shëndetësor dytësor ose shërbimet e rekomandimit (ku tjetrit i rekomandohet të shkojë). Në sistemet me akses

direkt tek specialisti, dallimi zakonisht bazohet në llojin e institucionit. Për shembull poliklinikat ofrojnë kujdes parësor dhe spitalet dytësor
Përkufizim plotësues: Kujdesi shëndetësor parësor është një kujdes shëndetësor esencial i arritshëm, me një kosto që vendi dhe komuniteti mund ta përballojnë, me metoda që janë praktike, shkencërisht të bazuara dhe të pranueshme nga pikëpamja sociale.

Private health care expenditure (Shpenzimi për kujdesin shëndetësor privat).Shih gjithashtu " Health care expenditure"
Ajo pjesë e shpenzimit total për shëndetin,e cila nuk është publike. Ajo përbëhet kryesisht nga pagesat nga xhepi dhe premiumet për sigurimin shëndetësor privat (ngandonjëhrë nga punëdhënësit në emër të individëve)
Shpenzimi për kujdesin shëndetësor privat plus shpenzimin për kujdesin shëndetësor publik është baraz me shpenzimin total për shëndetin.

Private health care sector (Sektori i kujdesit shëndetësor privat)
Sektori i kujdesit shëndetësor parësor i referohet si financimit ashtu edhe ofrimit të shërbimeve private.
Për financimin privat komponentë kryesorë janë sigurimi social privat, sigurime të tjera dhe pagesat nga xhepi.

Private patient (Pacient privat)
Një pacient i cili paguan të gjithë koston e të gjitha shërbimeve mjekësore dhe të tjera që i bëhen

Privatization (Privatizim).**Shih gjithashtu "Decentralization"**
Përfshin kalimin e pronësisë dhe funksioneve qeveritare nga organizmat publike në ato private, të cilat mund të konsistojnë në organizata vullnetare dhe organizata private fitim- ose jo fitim-prurëse. Shkalla e kontrollit shtetëror është e ndryshme.

Productivity (Produktivitet).
Volumi i *output*-it për njësi ose për *input*.
Produktiviteti shpesh shihet si produktivitet i punës

Process (Proces)
Një veprim i vazhdueshëm dhe i rregullt ose një vazhdim veprimesh, që ndodhin ose kryhen në një mënyrë të caktuar dhe që çojnë në përmbushjen e disa rezultateve.

Productivity cost (Kostoja e produktivitetit). Shih "Cost"

Profit (Fitim)
Ajo çka merret nga një biznes pasi janë plotësuar të gjitha shpenzimet operative ose e ardhura që merret nga një investim ose një pronë.

Progressive tax (Taksë progresive). Në dallim me "regressive tax"
Një taksë ku të pasurit paguajnë një porcion më të madh të të ardhurave të tyre sesa të varfërit.

Prospective study (Studim prospektiv)
Një studim në të cilin studjuesit planifikojnë dhe menaxhojnë ndërhyrjen për të cilën janë të interesuar në grupe pacientesh që ata i zgjedhin vetë. Në momentin e fillimit të studimit ata nuk e dinë se cilat do të jenë rezultatet e këtij studimi në kontrast me studimin retrospektiv.

Prospective payment (Pagesa prospektive). Në dallim me "Retrospective paymen". Shih gjithashtu "Payment"
Një pagesë niveli i të cilës fiksohet që më parë se sa të bëhet shërbimi. Për shembull rroga bazë është një lloj pagesë e tillë.
Shëmbuj të kesaj janë buxheti fiks dhe pagesa për frymë.

Provider (Ofrues)
Specialiste ose institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për pacientët.

Prevention (Parandalim)
Masat që synojnë promoconin dhe ruajtjen e shëndetit me ndërhyrje të tilla si përmirësim i statusit të ushqyerjes, imunizim, furnizim me ujë dhe higjienizim. Ky quhet edhe parandalimi parësor (primar). Parandalimi dytësor (sekondar) përfshin masa që synojnë sigurimin e zbulimit të hershëm të sëmundjeve dhe infeksioneve. Ndërsa parandalimi tretësor (terciar) merret me reduktimin e simptomatikes së sëmundjeve dhe paaftësinë.

Premature (Prematur)
I lindur para javës së 37 të barrës

Prevalence (Prevalencë)
Numri ose proporcioni i rasteve ose ngjarjeve ose gjendjeve shëndetësore në një popullatë të caktuar.

Prevalence rate (Shkalla e prevalencës)
Proporcioni i personave në një popullsi të cilët kanë një sëmundje të caktuar ose një atribut të caktuar në një moment në kohë ose gjatë një periudhe të caktuar kohe.

Propagated outbreak (Shpërthim me përhapje)
Një shpërthim që nuk ka vetëm një burim të përbashkët, por në fakt përhapet nga një person tek tjetri

Proportionate mortality (Vdekshmëria proporcionale)
Proporcioni i vdekjeve në një popullate të caktuar gjatë një periudhe kohe sipas shkaqeve të ndryshme. Çdo shkak shprehet si përqindje e të gjitha vdekjeve dhe shuma e të gjitha shkaqeve bën 100%. Këto proporcione nuk janë shkallë të vdekshmërisë pasi emëruesi në këtë rast përfaqësohet nga të gjitha vdekjet dhe jo nga popullsia në të cilën ndodhin vdekjet.

Public health (Shëndet publik)
Shkenca dhe arti i parandalimit të sëmundjes, zgjatjes së jetës dhe promocionit të shëndetit mendor dhe fizik dhe efiçiences përmes përpjekjeve të organizuara të shoqerisë.
Shëndeti publik është është një koncept social dhe politik që synon në përmirësimin e shëndetit, zgjatjen e jetës dhe përmirësimin e cilesisë së jetës midis gjithë popullsisë përmes promocionit, parandalimit të sëmundjeve dhe formave të tjera të ndërhyrjeve shëndetësore.

Public health care expenditure (Shpenzim për kujdesin shëndetësor publik). Shih gjithashtu "Private health care expenditure"
Përfshin kujdesin shëndetësor të financuar publikisht si nga ofruesit publikë ashtu dhe privatë. Fondet publike janë shteti, organizmat shtetërore rajonale dhe lokale dhe skemat e sigurimit social. Formimi i kapitalit publik për shëndetin përfshin investimet e financuara në mënyrë publike në institucionet shëndetësore plus transferimin e kapitalit në sektorin privat për ndërtimin e spitalit dhe pajisjen dhe subvencionimin nga qeveria të ofruesve të kujdesit shëndetësor parësor. Ai përfshin

fonde për të punësuar shtetëror.
Shpenzimet për kujdesin shëndetësor publik plus shpenzimet për kujdesin shëndetësor privat janë baraz me shpenzimet shëndetësore totale.

Public health care sector (Sektori i kujdesit shëndetësor publik)
I referohet financimit dhe ofrimit publik të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.
Meqë financimi dhe ofrimi publik shpesh nuk janë të njëjtë (për shembull paratë publike mund të financojnë shërbime jo publike, ndërsa parate private gjithashtu mund të financojnë shërbime publike) ky term nuk është shumë i dobishëm prandaj duhet shmangur.

Public Health Institute (Instituti i Shëndetit Public)
Vazhdues i Institutit Kërkimor të Higjienës e Epidemiologjisë dhe Prodhimeve Imunobiologjike. Merr statusin e ri me këtë emer në tetor 1995. Fokusohet në çështje të shëndetit publik.

Public health management (Menaxhimi i shëndetit publik)
Strukturat dhe proceset me anë të të cilave përcaktohen dhe zbatohen ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e shëndetit në shoqëri

Public health surveillance (Survejanca e shëndetit publik)
Një grumbullim sistematik, analizë, interpretim dhe shpërndarje e të dhënave shëndetësore mbi një bazë të vazhdueshme për të fituar njohuri mbi tablonë e shfaqjes dhe potencialit të sëmundjes në një popullatë të caktuar, në mënyrë që të kontrollohet dhe parandalohet sëmundja në këtë popullatë.

Public/private mix (Kombinimi, përzierja publike-private)
Kombinimi privato-publik i financimit dhe /ose ofrimit të shërbimeve.

Purchaser (Blerës)
Një organizem i kujdesit shëndetësor, i cili vlerëson nevojat e një popullsie të caktuar dhe blen shërbime për të plotësuar nevojat e ofruesve të kujdesit shëndetësor

Purchaser-provider split: Ndarja e funksioneve te bleresit dhe ofruesit sherbimeve shëndetësore, pra tjeter institucion merret me blerjen e sherbimeve dhe tjetër me ofrimin e tyre.

Purchasing Power Parity-PPP (Ekuivalenca e fuqisë blerëse)
PPP-të janë shkallët e konvertimit të valutës që barazojnë fuqinë blerëse për të gjithë serinë e mallrave dhe shërbimeve që përmbahen në GDP-në totale të një vendi
PPP-ja është një mjet i dobishëm për kalkulimin e GDP-së reale të një vendi. Ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht fuqinë blerëse për shërbimet shëndetësore, e cila është më e ulët nëse mallrat dhe shërbimet importohen nga vende me çmime më të larta.
Përkufizim plotësues: PPP-të janë shkallët e konvertimit valutor, të cilat eleminojnë diferencën në nivelin e çmimeve midis vendeve.

Q

Quality (Cilësi)
Një karakteristike, ose veti e çdo gjëje që e bën atë të mirë ose të keqe, të ngrenshme ose të kapshme pra shkalla se sa e mirë është diçka.
Tëresia e tipareve dhe karakteristikave të një produkti ose shërbimi që mbështetet në aftësinë e tij për të kënaqur nevojat e qarta apo të nënkuptuara.

Quality of life (Cilësi e jetës)
Përceptimi nga individet ose grupet e individeve se nevojat e tyre po plotësohen dhe se atyre nuk po i mohohen mundësitë për të arritur lumturinë dhe përmbushjen e jetës së tyre

Quality of medical care (Cilesia e kujdesit shëndetësor)
Shkalla sesa shërbimet shëndetësore për individë apo popullaten rrisin mundesinë e rezultateve shëndetësore të dëshirueshme dhe janë në përputhje me njohuritë profesioniste aktuale.
Përkufizim plotësues: Cilesia e kujdesit është ai komponent i diferencës midis efikasitetit dhe efektivitetit që mund ti atribuohet ofruesve të kujdesit shëndetësor, duke marrë në konsideratë mjedisin në të cilin ata punojnë.

QALY-Quality-Adjusted Life-Years (Vite jetë të modifikuar sipas cilësisë)
Një njësi matëse që kombinon vdekshmerinë dhe përirësimet në cilësinë e jetës (si rezultat i trajtimit mjeksor i matur si numri i viteve të jetës së fituar, i modifikuar sipas cilesisë).Llogariten duke matur vitet totale të humbura për shkak të një sëmundjeje ose të fituar nga trajtimi mjeksor, duke ponderuar çdo vit me një tregues (koefiçient) të cilësisë së jetës (nga 0 që përfaqëson shëndetin më të keq deri në 1 ose 100 që përfaqëson shëndetin më të mirë) për të pasqyryar cilesinë e jetës në atë vit.

Quarantine (Karantinë)
Izolimi i njerëzve, kafshëve, vendeve dhe efekteve që mbartin ose për të cilat dyshohet se mbartin sëmundje të transmetueshme. Fjala e ka origjinën tek pritja 40 ditëshe në radë gjatë të cilët anijet nuk mund të lejoheshin të shkarkonin pasagjërët ose ngarkesën e tyre në kohën kur murtaja dhe epidemi të tjera bënin kërdinë.

R

Random sample (Kampjon që merret rastesisht, kuturu)
Një kampion që merret duke i zgjedhur individët në mënyrë të tillë që çdo individ të këtë të njëjtin probabilitet selektimi.

Range (Shtrirje, diapazon)
Në statistike është diferenca midis vlerave më të mëdha dhe më të vogla në një shpërndarje. Në përdorimin e zakonshëm është diapazoni midis vlerave më të vogla dhe atyre më të medha.

Rate (Shkallë)
Një shprehje e frekuencës me të cilën një ngjarje ndodh në një popullsi të caktuar.

Ratio (Raport)
Vlera që merret duke pjestuar një sasi me një tjetër.

Rationing (Racionim)
Kufizimi i ofertës së shërbimeve sipas kritereve të fshehta apo të hapura, ku kërkesa kalon ofertën. Racionimi nënkupton mungesën e mekanizmave të tregut plotësisht funksionues për të lidhur kërkesën dhe ofertën.

Reliability (Besueshmeri)
Flitet kur nese një studim do te perseritej ai do te arrinte te njejtat rezultate.

Real Gross Domestic Product-real GDP (Prodhimi i brendshëm bruto real (Xhi-di-pi-ja reale). Shih gjithashtu "GDP"
GDP-ja e cila shprehet në ekuvalencën fuqiblerese dhe të adaptuar sipas fuqisë blerese vendase të valutës kombëtare e krahasuar me dollarin amerikan.
Shprehja e GDP-së si GDP reale ka avantazhe madhore. Ajo reflekton pagat dhe çmimet në vend dhe shmang ndryshimet të cilat i detyrohen vetëm shkallës së shkembimit (zyrtar) të valutës vendase ndaj dollarit amerikan. Në vendet me çmime të ulta GDP-ja reale është më e larte sesa GDP-ja, ndërsa në vendet me çmime të larta është e kundërta.

Reanimation: Kujdes intensiv. Kujdesi shëndetësor qe kerkon vemendje shumë te madhe dhe kujdes e mbajtje nen kontroll te vazhdueshem.

Recurrent expenditure (Shpenzime të përsëritshme, rrjedhëse).
Në dallim me shpenzimet kapitale "Capital expenditure"
Janë shpenzimet jo kapitale

Red ribon (Shiriti i kuq apo fjongoja e kuqe)
Në pranverë të vitit 1991 grupi i artistëve *Viusual Day* në New York hodhi idenë për një simbol mbarëbotëror në luftën kundër AIDS-it, një simbol për solidaritet dhe tolerancë ndaj njerëzve me HIV dhe me AIDS, shpesh të izoluar nga shoqëria. Duke u mbështetur edhe në shiritin e verdhë që qarkullonte shumë në atë kohe në Ameriken në kujtim të ushtareve që po luftonin në Luftën e Golfit,.lindi edhe fjongoja e kuqe. Kjo fjongo simbolizon solidaritetin mbarëbotëror me HIV pozitivet dhe të sëmurët me AIDS dhe bashkon njerëzit në luftën e përbashkët kundër kesaj sëmundjeje.

Reemerging infectious diseases (Sëmundje infektive që po rishfaqen)
Janë ato sëmundje që dikur konsideroheshin nën kontroll dhe që në zona relativisht të mëdha të rruzullit tokësor nuk përbënin më ndonjë problem për shëndetin publik, por që tani për disa arsye janë rikthyer me forcë, si për shembull tuberkulozi, malaria apo disa sëmundje të transmetuara me rrugë seksuale.

Reference price (Çmimi i referencës)
Çmimi maksimum për një grup produktesh të njëjtë ose të ngjashëm (kryesisht medikamente) që një palë e tretë paguese është e gatshme ti rimbursojë.

Referral hospital (Spitale të rekomandimit)
Nënkupton ato spitale ku mjeku i përgjithshëm apo mjeku i familjes dërgon një pacient të tij për shkak se ky i fundit ka nevojë për një shërbim më të specializuar

Reform (Reformë)
Një proces i qëllimshëm, dinamik që përfshin ndryshime politike sistematike, strukturore dhe të procesit dhe që synon në arritjen e qëllimeve të dëshirueshme.

Regional Committee for Europe of WHO (Komiteti Rajonal për Evropen i OBSH-së)
Eshte forumi më i larte i Zyres Rajonale të OBSH-së Perfaqësuesit e çdo Shteti Anëtar të Rajonit Evropian përbëjnë Komitetin Rajonal për Evropën. Ai mblidhet një herë në vit në shtator për 5 ditë. Ne këto takime shtetet anëtare formulojnë politika rajonale, rekomandojnë dhe mbikqyrin aktivitetet e OBSH-së për Evropën dhe miratojnë buxhetin. Vendimet e tyre marrin formën e rezolutave që janë baza për punën e mëtejshme në Rajonin Evropian

Regional Health Authority of Tirana (Autoriteti Shëndetësor Rajonal i Tiranës-ASHR)
Një organizëm i ri që ka filluar punë në vitin 2001 me synim përmirësimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor parësor në rrethin e Tiranës përmes një mënyre të re të menaxhimit, planifikimit dhe financimit

Regional hospital (Spital rajonal)
Spital që përveç popullsisë së rrethit ku është vendosur i sherben edhe qarqeve. Duke mbajtur parasysh ndarjen administraitve të Shqipërisë sot mund të ishte edhe spitali qarku. Përveç specialiteteve që ka një spital rrethi aty ka edhe shërbime të tjera më të specializuara si okulitstikë, otorinolaringologji, kardiologji etj. Numri i shtretërve shkon nga 200-400.

Registered drug (Bar i regjistruar)
Bar që ka kaluar procedurën e regjistrimit dhe pas dhënies së çertifikatës së regjistrimit qarkullon në tregun farmaceutik shqiptar.

Regressive tax (Taksa regresive). Në dallim me "Progressive tax"
Një taksë në të cilën i varfëri paguan një porcion më të madh të të ardhurës sesa i pasuri.

Regulation (Regullim)
Ndërhyrje nga qeveria me anë të rregullave, në tregjet apo sistemet e kujdesit shëndetësor. Regullimi përfshin një numër të gjërë mekanizmash, nga aktet ligjore tek kërkesat e imponuara administrativisht për raportim dhe prej stimujve pozitivë si subvencionimet deri tek stimujt negativë si sanksionet legale.
Përkufizim plotësues: Konsiderohet si një marrëveshje e standarteve të ndryshëm dhe zbatimi i tyre

Reimbursement (Rimbursim). Shih "Retrospective payment"

Relative risk (Risku relativ)
Krahasimi i riskut midis dy grupeve për një problem shëndetësor si sëmundja apo vdekja.
Relevance: Shkalla se sa objektivat e një programi ose projekti mbeten te vlefshme dhe perkatese nese krahasohen me atë çka ishte planifikuar.
Remuneration (Shpërblim)
Një kompensim për specialistët e shëndetit për kohën dhe përpjekjet e tyre në sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Representative sample (Kampion përfaqësues)
Një kampion karakteristikat e të cilit i korespondojnë atyre të popullatës origjinale apo asaj të referimit.

Reproductive health (Shëndet riprodhues)
Shëndeti riprodhues është një gjendje e mirëqënjes së plotë fizike mendore dhe sociale dhe jo vetëm mungesa e sëmundjes apo të qënit i pamundur në çeshtje që lidhen me sistemin riprodhues, funksionet dhe procesin e tij. Shëndeti riprodhues trajton proceset, funksionet dhe sistemin e riprodhimit në të gjitha stadet e jetës. Ai nënkupton që njerëzit janë të aftë të kenë një jetë të përgjegjshme, të kënaqshme dhe të sigurtë seksuale dhe se ata kanë aftësinë për të riprodhuar dhe lirinë për të vendosur se kur dhe se sa shpesh ata e bëjnë një gjë të tillë.

Reservoir (Rezervuar)
Habitati në të cilin një agjent infektiv jeton, rritet dhe shumohet.normalisht. Ai përfshin rezervuarin njerëzor, atë shtazor dhe atë mjedisor.

Resistance (Rezistencë)
Aftësia e një agjenti infektiv për të mposhtur efektin e një medikamenti ndaj tij. Për shembull përdorimi për një kohë të gjatë i medikamentit kundër HIV-it AZT mund të shkaktojë rezistence dhe medikamenti të mos veprojë me ndjaj tij me të njëjtën forcë apo të mos veprojë fare.

Resources (Burime)
Input-et bazë për prodhimin e diçkaje si koha dhe aftësitë e individëve (burimet njerëzore), lenda e parë si toka dhe burimet natyrore (ajri,uji,mineralet etj),transformimi dhe grumbullimi i tyre në kapital (pajisje,aparatura) dhe njohuritë mbi procesin e prodhimit (teknologjite).

Resource costs (Kostot e burimeve). Shih "Costs"

Retail sale (Shitje me pakicë)
Përdoret kryesisht në shitjen e medikamenteve dhe i referohet për shembull shitjes së një medikamenti në farmaci

Retrospective payment (Pagesa retrospektive). Në dallim me "Prospective payments. Shih gjithashtu "Fee for service" dhe "Contracts"
Një skemë pagese, niveli i së cilës përcaktohet vetëm pasi shërbimet janë ofruar.
I quajtur gjithashtu rimbursim. Forma të tij janë tarifat për shërbim, kosto/tarife për rast dhe pagesat për ditë.
Përkufizim plotësues: Shpërblim i ofruesve mbi bazën e aktiviteteve ose kostos.

Retrospective study (Studim retrospektiv)
Një studim në të cilin kërkuesit zgjedhin një grup pacientesh që tashmë është trajtuar dhe analizojnë

të dhënat nga ngjarjet të cilat keta pacientë kane kaluar. Këto studime janë subjekt i njëanshmërisë, sepse studiuesit mund të zgjedhin grupin e pacientëve me rezultate tashmë të njohura.

Risk aversion (Mospëlqyerje e riskut)
Shkalla deri ku një individ është gati të paguajë për të reduktuar variacionin e humbjeve ose të të ardhurave si pasojë e ngjarjeve rastësore.

Risk pooling (Grumbullim i përbashkët i riskut)
Formimi i një grupi në mënyrë që risqet individuale mund të ndahen midis shumë njerëzve.
Përkufizim plotësues: Aktorë ku cilido prej te cilëve mund të përballet me humbje të medha, bien në ujdi për të kontribuar me një premium të vogël në një shportë të përbashkët për ta përdorur për të kompensuar çdo njërin prej tyre nëse ai pëson humbje. Kontributet duhet të mbulojnë humbjet plus shpenzimet administrative.

Risk selection (Përzgjedhje e riskut). Shih gjithashtu "Cream skimming"
Rekrutimi i personave më të shëndetshëm sesa mesatarja në një grup të siguruarish.
Kompanitë e sigurimit shpesh kanë rregulla dhe kontrollojnë bilancet për ti penguar ato që të bëjnë përzgjedhje të risqeve.

Risk (Risk, rrezik)
Probabiliteti që të shfaqet një problem shëndetësor, pra që një individ të sëmuret ose të vdesë brenda një periudhe kohe të caktuar ose moshe të caktuar.

Risk factor (Faktor risku)
Një aspekt i sjelljes personale ose i stilit të jetës, ekspozimit ose një karakteristike individuale që mund të jetë e trasheguar, i cili dihet që lidhet me dëmtiminin e shëndetit dhe që konsiderohet i rëndesishëm në parandalimin e problemeve shëndetësore dhe që mund të modifikohen nga zbatimi i një programi shëndetësor.

Risk ratio (Raporti i risku)
Krahasimi i riskut midis dy grupeve për një ngjarje shëndetësore si sëmundja apo vdekja.

Rotary international
OJQ e themeluar me qëllimin për të zbatuar idealet e shërbimit për biznesin dhe jetën profesionale. Krijuar në 1905 në Chicago. Tani përfshin klube në shumë vende të botës. Bashkëpunon me OBSH-në luftën kundër polios. Është aktiv edhe në Shqipëri nga 11 maji i vitit 1992.

S

Salary (Rroge). Shih gjithashtu "Payment"
Shpërblim (prospektiv, i berë që më parë), i cili është fiks për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk ndryshon , pavarësisht nga numri i personave të cileve i shërbehet apo nga numri i shërbimeve të kryera. Pra një lloj rroge bazë.
Ky sistem lidhet kryesisht me punësimin direkt nga një organizate.
Përkufizim plotësues: Një mekanizëm pagese kur një specialist i shëndetësisë merr një shumë të përcaktuar parashë për të përmbushur përgjegjësi të caktuara për një organizatë,

Seasonality (Sezonabilitet)
Ndryshim në gjendjen fiziologjike ose në shfaqjen e sëmundjes sipas stinëve

Secondary health care (Kujdes shëndetësor dytësor)
Shih gjithashtu "Primary health care" "Tertiary health care"
Shërbim i specializuar ambulator dhe kujdes spitalor i zakonshëm (shërbime me pacientë ambulatorë dhe të shtruar).
Shpesh futja në të është përmes rekomandimit nga shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.
Nuk përfshin shërbimet teknike mjekësore shumë të specializuara për pacientë të shtruar
(i cili është kujdesi shëndetësor tretësor)
Përkufizim plotësues:.Kujdes që ofrohet nga specialistët mjekësorë, zakonisht në spitale, por gjithashtu edhe në disa shërbime të specializuara që i ofrohen komunitetit.

Secular trend (Tendencë sekulare)
Ndyshime për një periudhë të gjatë kohe, përgjithësisht për vite apo dekada

Semashko system (Sistemi Semashko)
Një model uniform i organizimit të shërbimeve shëndetësore në vendet e Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore, që u hoq në fillimet e viteve 90. Financimi i shërbimeve shëndetësore bëhej teresisht përmes buxhetit shtetëror, me institucione të kujdesit shëndetësor pronë publike. Për planifikimin, alokimin e burimeve dhe menaxhimin e shpenzimeve kapitale ishin përgjegjës nivele të ndryshme të administrates shtetërore si ai qëndror, rajonal dhe lokal.
Sistemi ka një strukture vertikale, me përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të sakte.

Sensitivity (Sensitivitet)
Aftësia e një sistemi për të zbuluar epidemi ose ndryshime të tjera në shfaqjen e sëmundjes. Po ashtu edhe proporcioni i personave me sëmundje të cilët identifikohen në mënyrë korrekte përmes një testi kontrolli ose sipas përkufizimit të rastit se kanë këtë sëmundje.

Seropositive (Seropozitiv)
Thuhet për gjakun i cili shfaq shenja të pranisë së kundërtrupave. Nomarlisht përdoret për personat e infektuar, por që nuk kanë shenja të sëmundjes

Sewage (Ujra të zeza)
Shkarkime të lëngëta nga bashkësi njerëzore, që rrjedhin në gypa.

Sex-specific mortality rate (Shkalla e vdekshmërisë sipas seksit)
Një shkallë vdekshmërie për femrat apo meshkujt.

Sexually transmitted diseases-STDs (Sëmundje të transmetuara seksualisht)
Këto sëmundje përfshijnë herpesin, sifilisin, gonorenë, klamidjen, HIV/AIDS dhe të tjera. Ato e bëjnë më të lehtë përhapjen e HIV nga një person tek tjetri nga dëmtimi që shkaktojnë në organet seksuale.. Aktualisht përdoret termi infeksione të transmetuara seksualisht.(STI)

Sexual health (Shëndeti seksual)
Integrimi i aspekteve somatike, emocionale,intelektuale dhe sociale të një qënie seksuale në mënyrë të tillë që pasuron dhe rrit pozitivisht personalitetin, komunikimin dhe dashurinë.

Sexually transmited infections, shkurt STI (Infeksione seksualisht të transmetueshme)
Janë ato infeksione që përhapen përmes kontaktit seksual

Sickness fund (Fond për sëmundjen, sigurim shëndetësor)
Pagues si palë e tretë në sistemin e sigurimit shëndetësor social,që mbulon të gjithë komunitetin ose një pjesë të tij.
Fondet e sëmundjes zakonisht janë organizma gati publike. Në Francë dhe Belgjikë ato quhen "mutualities". Sinonime të tjera janë "sick funds"(fond kur je i sëmurë) dhe"health insurance funds"(fonde të sigurisë shëndetësore). Në sistemin e Llogarisë Shëndetësore të OECD-së, fondet e sëmundjes futen në kategorinë e "fondeve të sigurimit social" nëse ato imponohen ose kontrollohen nga qeveria.

SIDA
Shkurtimi në frëngjisht për AIDS-in

Sin tax (Taksë mëkati)
Taksë për mallra (lluksi) që kanë efekt të dëmshëm mbi shëndetin si alkoli, duhani etj.

Skewed (I anuar ,i shtrembëruar)
Një shpërndarje, e cila është asimetrike.

Social capital (Kapitali social)
Kapitali social përfaqëson shkallën e kohezionit social i cili ekziston në komunitete. Ai i referohet proceseve midis njerëzve të cilët ndërtojnë rrjete, norma dhe besim social dhe lehtësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin për përfitim reciprok.

Social care (Kujdes social)
Shërbime që kanë të bëjnë me kujdesin për pacientet e shtruar afatgjatë plus shërbimet e komunitetit, si qendrat e kujdesit ditor dhe shërbimet sociale për të sëmuret kronike, të moshuarit dhe grupe të tjera me nevoja të veçanta si të sëmuret mendorë dhe invalidet fizikë.
Kufiri midis kujdesit social dhe kujdesit shëndetësor ndryshon nga një vend në tjetrin, veçanerisht për sa i takon shërbimeve sociale, të cilat përfshijnë një komponent të rëndesishëm, por jo dominant të kujdesit shëndetësor siç është për shembull kujdesi shëndetësor afatgjatë për të moshuar që nuk bëjnë dot një jetë të pavarur.

Social health insurance (Sigurimi shëndetësor social). Shih gjithashtu "Bismarckian health system"
Sigurimi shëndetësor social është një program i sigurimit, i cili plotëson të paktën tre kushtet e mëposhtme:
Pjesëmarrja në program është e detyrueshme ose me ligj ose përmes kushteve të punësimit.
Progami vepron në emër të një grupi ose kufizohet tek një grup njerëzish ose një punëdhënës kontribuon në program në emër të një të punësuari

Individet e siguruar japin kontribute të rregullta, kryesisht mbi bazën e të ardhurave që nuk lidhen me koston e shërbimeve që ata përdorin..Kontributet administrohen nga një ose më shumë organizma publike gati të pavarur, zakonisht me përgjegjësi statutore (të quajtur zakonisht fonde të sëmundjes), të cilët veprojnë si pagues/blerës të kujdesit shëndetësor. Grumbullimi aktual i kontributeve mund të organizohet gjithashtu përmes institucioneve qeveritare. Nëse sigurimi shëndetësor mandatohet nga qeveria, ai quhet gjithashtu sigurim shëndetësor statutor.

Social marginalization (Emarxhinimi social)
Procesi me anë të të cilit grupet vulnerabël mund të pengohen nga pjesëmarrja e plotë në jetën sociale, politike dhe ekonomike në komunitet. Kjo ndodh kur mungojnë politikat dhe mekanizmat e nevojshëm ndërsektoriale për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë.

Social safety net (Rjeti i sigurisë sociale)
Një organizim bazë për të siguruar se çdo person në shoqëri mund të marrë ndihmë financiare dhe materiale nga shteti, për të shmangur varfërinë absolute dhe për të siguruar mbijetesën.

Social security (Siguri sociale)
Ofrimi i mbrojtes sociale ndaj një numri risqesh, si pamundësia për të punuar si pasojë e sëmundjes ose paaftësisë, papunësisë, moshës së thyer ose mbajtjes së familjes.

Socio-economical status (Statusi social-ekonomik)
Një klasifikim përshkrues i pozitës së një individi në shoqëri duke përdorur kritere të tilla si të ardhurat, niveli arsimor, punësimi dhe vendbanimi.

Sorros foundation (Fondacioni Sorros)
Fusha kryesore të ndërhyrjes në shëndetesi është edukimi shëndetësor, ndihma OJQ-ve të shëndetit, ndihma për njerëzit me paaftësi dhe hadikapatë, trajnim etj.

Specificity (Specificitet)
Proporcioni i personave pa sëmundje, të cilët aktualisht identifikohen nga një test kontrolli ose përmes përcaktimit të rastit si persona që nuk kanë një sëmundje të caktuar.

Spot map (Harte vendtreguese)
Një hartë që tregon vendndodhjen e çdo rasti me një sëmundje ose shpërthim

Specialist (Specialist)
Një mjek i cili ka plotësuar një trajnim pas-universitar dhe pastaj është liçensuar si ekspert në një fushe specifike të mjekësisë.

Speciality (Specialitet)
Një degë e mjeksisë si ortopedia, pediatria, psikiatria (të cilat kërkojnë trajnim të specializuar)

Stakeholders (Aktorë)
Grupe që kanë interes në organizimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor si pacientet, paguesit, mjekët praktikues

Standard deviation (Deviacioni standart)
Masë e përdorur më tepër për dispersionin e një frekuence. Është e barabartë me rënjën katrore të variancës.

Standardised mortality ratio/rate –SMR (Raporti/shkalla e standartizuar e vdekshmërisë)
Numri i vdekjeve në një vit të dhënë si përqindje e atyre të pritshme.
(të pritshme=vdekshmëria standard e periudhës së referimit e përshtatur sipas moshës dhe seksit.).
Është një masë e mirë për të krahasuar të dhënat e vdekshmërisë, që bazohen mbi një numër të vogel rastesh ose për krahsimin e të dhënave të vdekshmërisë sipas zonave gjeografike.
Përkufizim plotësues:Raporti i numrit të vdekjeve për banorët e një zone gjeografike mbi numrin e vdekjeve të pritshme bazuar mbi shkallën e vdekshmërisë sipas moshës.

Statistical inference (Konkludim statistikor)
Në statistikë është përgjithësimi nga të dhenat prej kampionëve (mostrave), zakonisht me një shkallë përllogaritje pasigurie.

Statutory health insurance (Sigurim shëndetësor statutor). Shih "Compulsory health insurance" dhe "Social health insurance"

Stewardship (Të përkujdesurit, kujdes në drejtim)
Një funksion i qeverisë që ka te bëjë me përgjegjesinë për mirëqënien e popullsisë dhe me besimin e legjitimitetin me të cilin aktivitetet e saj shihen nga qytetarët. Më rëndom ne e përkthejmë si funksioni drejtues, drejtimi . Më konkretisht ai nënkupton funksionet kryesore të ministrisë së shëndetësisë , strukturën e saj, politikat dhe strategjitë shëndetësore, veprimet ndërsektoriale, informacionin shëndetësor, kornizën ligjore, qeverisjen dhe zhvillimin e sistemit etj. Është njëri prej katër funsioneve të sistemit shëndetësor. Ashtu si dhe fjala "governance" edhe kjo fjalë nuk përkthehet kollaj në gjuhë të tjera.

Strategy (Strategy)
Një kurs veprimi afatgjatë dhe i gjërë që siguron kornizën për veprimtari dhe ngjarje individuale.

Subscribers (Abonentë). Shih "Beneficiaries"

Subsidy (Subvencionim)
Një pagesë e bërë nga qeveria me objektivin e reduktimit të çmimit të tregut të një produkti të caktuar ose të ruajtjes të së ardhurave të prodhuesit.

Substitution effect (Efekti zëvendësues)
Një proporcion ndryshimi në kërkesë si pasojë e ndryshimit të çmimeve relative.
Një rritje e çmimit redukton kërkesën për një mall, ndërsa mund të rritet kërkesa për një zevëndësues të tij.

Sufficient cause (Shkak i mjaftueshëm)
Një faktor shkaktar ose një grumbull faktoresh prania e të cilëve gjithmonë pasohet nga shfaqja e efektit (sëmundjes)

Superior good (Mall superior). Shih "Goods"

Supplier-induced demand (Kërkesë e nxitur nga ofruesi)
Një fenomen ku një ofrues i shërbimit shëndetësor, zakonisht një mjek, ndikon nivelin e kërkesës së një personi për shërbime të kujdesit shëndetësor.
Kërkesa e nxitur nga ofruesi buron nga ekzistenca e asimetrisë së informacionit midis pacientit dhe ofruesit
Etika profesionale inkurajon kërkesën e nxitur nga ofruesi në interes të pacientit, sepse pacienti shpesh ka informacion të pamjaftueshëm për të gjykuar se çfare shërbimesh do të përmirësonin

shëndetin e tij. Ofruesit e shërbimeve shëndetësore shfrytëzojnë avantazhin e tyre superior të informacionit për të nxitur kërkesën për interesat e tyre. Kjo është një çeshtje e rëndesishme në sektorin shëndetësor.

Supply (Ofertë)
Sasia e një produkti që vihet në dispozicion për shitje me një çmim të caktuar.
Në një kuptim më të gjërë, shpesh përdoret për *imput*-e pra duke përfshirë të gjitha burimet shëndetësore

Surgery (Qendër shëndetësore)
Qendër ku ofrohet shërbimi parësor kryesisht diagnostikues dhe kurues.

Surveillance (Survejancë)
Grumbullim i vazhdueshëm i informacionit mbi zhvillimin brënda një sektori

Survey (Studim vëzhgues)
Procesi i grumbullimit të informacionit duke marrë në pyetje një grup të zgjedhur.
Normalisht përfshin shpërndarjen e pyetësoreve të shkruar

Survival curve (Kurba e mbijetesës)
Një kurbë që fillon me 100% të popullsisë në studim dhe tregon përqindjen e popullsisë ende mbijetuese në vazhdimësi për aq kohe sa informacioni është i disponueshëm

Susceptible (I ndjeshëm, i prekshëm)
Një individ i ndjeshëm, i prekshëm,i kapshëm prej infeksionit nga një shkaktar patogjen

Sustainability (Qëndrueshmëri)
Aftësia për të plotësuar nevojat e së tashmes, pa demtuar aftësinë për të plotësuar nevojat e së ardhmes.

Sustainable development (Zhvillim i qëndrueshëm)
Është ai zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.
SWOT Analysis: Perfshin analizen e aneve te forta dhe te dobta (S=Strong dhe W=Weakness) dhe nje analize te shanceve dhe te rreziqeve (O=Opportunities-T=Threats)

T

Target (Shënjestër)
Përfaqëson një lloj objektivi që duhet të arrihet. Është me specifik se një objektiv i zakonshëm dhe zakonisht përcakton atë që duhet të arrihet nga pikëpamja sasiore dhe kohore. Përdoret në Shëndetin për të Gjithë. Për shembull : Në të gjitha vendet në vitin 2015 konsumi i alkolit për frymë nuk duhet të kalojë 6 litra në vit.

Target income (E ardhur shënjestër)
Një e ardhur që presupozohet se ofruesi i shërbimit shëndetësor duhet të synojë
Përkufizim plotësues: Sasia e shërbimeve ose e tarifave që rregullohen në mënyrë të tillë që të arrijnë të ardhura specifike.

Target of Health for All (Shënjestër e Shëndetit për të Gjithë)
Shënjester evropiane ose kombëtare është një synim drejt të cilit tentohet në përputhje me një politike evropiane ose kombëtare të Shëndetit për të Gjithë. Ajo presupozon një vullnet politik në zotimin për të përdorur burimet e vendit drejt arritjes së këtij synimi.

Technical efficiency (Efiçience teknike).Shih "Efficiency"

Technology assessment in health care (Vlerësimi i teknologjisë në kujdesin shëndetësor).Shih "Health technology assessment"

Tertiary health care (Kujdes shëndetësor tretësor).
Shih gjithashtu "Primary health care" dhe "Secondary health care"
I referohet shërbimeve mjekësore dhe shërbimeve që lidhen me to, që janë tepër komplekse dhe zakonisht me kosto të lartë.
Ata pacientë që cilët rekomandohen prej kujdesit shëndetësor dytësor për diagnoze dhe trajtim që nuk mund ta bëjë dot në kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor. Kujdesi shëndetësor tretësor zakonisht është i disponueshëm në nivel kombëtar ose në qendra ndërkombëtare të referencës.

Third-party payer (Pagues i palës së tretë)
Çdo organizatë publike apo private,që paguan ose siguron shpenzime të kujdesit shëndetësor për përfituesit gjatë kohës në të cilen ata janë paciente.
I referohet situatave kur pala e parë (pacienti) nuk paguan direkt për aktivitetet e palës së dyte (ofruesi, doktori), por përmes një pale të tretë të një siguruesi privat, fondi sigurimesh ose një agjensie qeveritare (pagues i palës së tretë)

Total expenditure on health (Shpenzimi total për shëndetin)
Shpenzim total ose kombëtar për shëndetin që bazohet në kufijtë e mëposhtëm identifikues dhe funksionale të kujdesit mjekësor:
Shërbimet e kujdesit shëndetësor personal+mallrat mjekësore të harxhuara për pacientë ambulatore= shpenzimet totale personale për shëndetin+ shërbimet parandaluese dhe shëndeti publik+ administrimi shëndetësor dhe sigurimi shëndetësor= shpenzimet korente totale për shëndetin+ investimi për institucionet shëndetësore=shpenzimet totale për shëndetin
Një tjetër formulë është : shpenzimi total për shëndetin=shpenzimi për kujdesin shëndetësor privat+shpenzimet për kujdesin shëndetësor publik.

Trade off: Lëshim, kompromis. Pranimi i diçkaje më të keqe në një drejtim për hir të një të mire në një drejtim tjetër

Transaction costs (Kosto të transaksioneve)
Kosto që lindin nga procesi i bisedimit midis blerësve (pagues të palës së tretë/blerës) dhe shitësve (ofruesit e shërbimeve, mjeket etj)
Kostot e transaksioneve përfshijnë për shembull hartimin e kontratave etj. Këto reduktojnë përfitimin e bërjes biznes në treg.

Transitional economy (Ekonomi në tranzicion)
Term që përdoret për të përshkruar ekonomitë, të cilat administroheshin me komandë, por që tani po i japin gjithënjë e më rëndësi forcave të tregut.
Siç e nënkuton vetë emri ato janë ende në procesin e reformës dhe nuk kanë kaluar tërësisht në ekonominë e tregut.

Transmission of infection (Transmetimi i infeksionit)
Çdo mënyrë ose mekanizëm me anë të cilit një agjent infektiv përhapet në një mjedis ose tek një person tjetër.

Trend (Tendencë)
Një levizje ose ndryshim afatgjatë me frekuencë zakonisht për nga lartë ose poshtë

Triage (Triazh): Një proces i ndarjes të të sëmureve ose të të plagosurve bazuar në nevojën e tyre për trajtim mjekësor. Një spital triazhi zakonisht përdoret në urgjencë, ku stafi mjeksor vendos se kush duhet te trajtohet më parë.

U

UNAIDS-Programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV/AIDS.
Është një *joint-venture* inovative e familjes së Kombeve të Bashkuara për të harmonizuar më mirë luftën kundër AIDS-it UNAIDS. Bashkon përpjekjet dhe burimet e tetë organizatave të Kombeve të Bashkuara., ndër to UNICEF, PNUD, UNFPA, UNESCO, Banka Botërore, OBSH për të ndihmuar botën që të parandalojë infeksionet e reja me HIV, të kujdeset për ata që tashmë janë të infektuar dhe të zbusë impaktin e epidemisë. Është krijuar në vitin 1995. Fillon punën në vitin 1996

Under-the-table payments (Pagesë nën tavolinë, nën dorë)
Pagesa jo zyrtare, të cilat zakonisht janë të ndaluara, dhe që bëhen në mënyrë që të plotësohen deshirat, kërkesat, nevojat e dikujt në kohën e duhur, në një shtrirje më të madhe sesa duke ndjekur rregullat dhe rregulloret zyrtare
Quhen gjithashtu edhe pagesa në zarf.

U N D P - Shkurtim në anglisht për « United Nation Development Program » (PNUD)
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin. Themeluar në 1965. Fillon veprimtarinë në vitin 1969. Në Shqipëri që prej 1991. Duke ndihmuar ndër të tjera në përmirësimin e cilësisë së jetës, kontribuon për një shëndet me të mirë.

U N E P - Shkurt në anglisht për "United Nations Environment Programme"
(Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin.Themeluar në 1973.

U N E S C O - Shkurtim në anglisht për "United Nations Educational Scientific and Cultural Organization"
Organizata për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën e OKB-së.
Themeluar në 1946. Qendra në Paris.

U N F P A - Shkurt për « United Nation Fund for Population » (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullaten).
Fokusohet në shëndetin riprodhues duke përfshirë planifikimin familiar, strategjitë mbi popullsinë dhe zhvillimin, keshillimin. Themeluar në 1967, që prej 1972 nën PNUD-in. Zyra në Shqipëri është hapur në vitin 1996, ndërkohë që projektet kanë filluar që në vitin 1991.

UN I C E F - Shkurt në anglisht për "United National International Children´s Emergency Fund " (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet). Themeluar në 1946. Fillimisht për të lehtësuar pasojat e luftës. Tani merret me mirëqënien e fëmijeve në vendet në zhvillim . UNICEF ka marrë mandatin e Asamblesë së Pergjithshme të Kombeve të Bashkuara që të mbrojë të drejtat e fëmijëve, të ndihmojë për përmbushjen e nevojave të tyre bazë dhe zgjerojë mundesinë e tyre për të arritur potencialin tyre të plotë. Qendra në New York. Prania shumë aktive në Shqipëri që në 1992 edhe në fushën e shëndetesisë.

Universal health insurance (Sigurim shëndetësor universal)
Një plan kombëtar që ofron sigurim shëndetësor ose shërbime për të gjithë qytetaret ose të gjithë njerëzit që ndodhen në një vend..

University Hospital Ceter “Mother Tereza” in Tirana Qendra Universitare Spitalore Nënë Tereza” ne Tiranë)
Eshte i vetmi spital qe ofron sherbim terciar. Njëkohesisht ai ofron edhe shërbim sekondar per rajonin e Tiranës. Ka 1527 shtretër.

U S A I D - Shkurt në anglisht për "United States Agency for International Development". (Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar). Aktiviteti në Shqipëri ka filluar nga fundi i 1991 dhe zyra në Tirane është hapur në janar 1992. Aktiv në Shqipëri edhe në fushën e shëndetit. Fushat kryesore të ndërhyrjes janë nxitja e tregut shëndetësor privat, partneriteti midis spitaleve, shëndeti i grave etj

User charge/fee (Pagesa, tarifa të përdoruesit). Shih gjithashtu "Cost sharing"
Tarifate përdoruesit janë pagesa për mallra dhe shërbime që përdoruesi ose pacienti duhet të paguajë.
Tarifat që vihen për shërbimet shëndetësore ose medikamentet mund të përdoren për të frenuar koston e ofrimit të shërbimeve dhe të ndikojnë kërkesën për këto produkte.Ato mund të përdoren gjithashtu me objektivin e sigurimit të të ardhurave për investime shtetërore. Taksat e përdoruesit nuk reflektojnë domosdoshmerisht koston. Termi zakonisht i rezervohet situatave në mungesë të sigurimeve shëndetësore (ndryshe ato quhen bashkëpagesa)

User cost (Kostoja e përdoruesit)
Shih "Costs"

Utilities
Jane sherbimet qe normalisht perfshijne elektricitetin, ujin dhe gazin.

Utilization (Shfrytëzim)
Numri i shërbimeve shëndetësore të përdorura, shpesh i shprehur për 1000 persona në muaj ose vit.

V

Vaccine (Vaksinë)
Një suspencion i një agjenti infektiv (për shembull virus) ose i pjesëve të tija. Suspensioni jepet (zakonisht me injeksion) në mënyrë që të japë rezistencë ose imunitet ndaj agjentit infektiv. Tani janë duke u studjuar dhe zhvilluar tipe të tjera vaksinash si ato terapeutike.Vaksinat terapeutike mund të ndihmojnë në luftën ndaj HIV-it

Validity (Vlefshmëri,validitet)
Shkalla , se sa aktualisht një matje mat ose zbulon atë që duhej të masë apo zbulojë.

Value of Health for All (Vlera e Shëndetit për të Gjithë)
Shëndeti si e drejtë njerëzore, barazia në shëndet dhe solidariteti, pjesëmarrje dhe përgjegjësi.

Variable (Variabël)
Çdo karakteristikë ose atribut që mund të matet.

Variable cost (Kosto e ndryshueshme, variable). **Shih "Cost"**

Vector (Vektor)
Një qënie e ndërmjetme në zinxhirin e transmetimit indirekt të një agjenti, që mbart agjentin nga rezervuari tek strehuesi i ndjeshëm

Vector-borne diserase (Sëmundje që mbartet nga vektoret)
Një sëmundje që transmentohet tek njerëzit apo kafshët nga një insekt si një mushkonjë ose ndonjë tjetër arthopod.

Vehicle (Mjet transporti)
Një ndërmjetës jo i gjallë në transmetimin indirekt të një agjenti që e mbart agjentin nga rezervuari tek strehuesi i ndjeshëm.

Vertical equity (Ekuitet vertikal). Shih "Equity"

Virus
Një mikroorganizëm jashtëzakonisht i vogël i përbërë nga fije AND-je (Ndonjëherë edhe ARN) e rrethuar nga një membranë proteinike.Viruset janë organizmat më të vegjël infektive të njohur dhe nuk janë në gjendje të jetojnë ose të shumohen jashtë qelizës strehuese. Viruset mund të shkaktojnë sëmundje infektive (për shembull linë, polion, gripin, herpesin). Ka disa viruse që në kushte normale nuk shkaktojnë sëmundje tek njerëzit por mund të behen kërcënues për jetën në rastin kur njeriu është i infektuar me HIV dhe ka AIDS.

Virulence (Virulencë)
Shkalla e patogjenicitetit te një mikroorganizmi që shfaqet me gravitetin e sëmundjes

Vital statistics (Statistika jetësore)
Informacion i grumbulluar statistikisht në lidhje me lindjet, martesat, divorcet dhe vdekjet bazuar mbi regjistrimet e ketyre ngjarjeve jetësore

Voluntary health insurance (Sigurim shëndetësor vullnetar). Në dallim me "Compulsory/Statutory health insurance"

Sigurim shëndetësor i cili merret përsipër nga individet dhe paguhet sipas dëshirës së individëve (drejtpërsedrejti ose përmes punëdhënësve)
Sigurimi vullnetar zakonisht blihet nga një organizatë e sigurimit privat, megjithëse në disa raste ai mund të blihet gjithashtu prej organizmave publike ose gati publike. Krahas shpenzimit nga xhepi, shpenzimi për sigurimin vullnetar është komponenti madhor i shpenzimeve shëndetësore private.

W

Waiting list (Lista e pritjes)
Numri i njerëzve që presin shtrimin në spital
Gjithashtu përdoret për kujdesin ambulator të specializuar.
për disa proceduara mjekësore si për shembull zevendesimi i këmbës

Waiting period (Periudha pritëse)
Periudha që një i siguruar duhet të presë përpara se ai të mund të përfitojë nga sigurimet.
Periudha e pritjes nuk duhet të ngatërohet me kohën e pritjes.

Waiting time (Koha e pritjes)
Koha që kalon midis 1) kërkesës që i bëhet një mjeku të përgjithshëm për një takim dhe pritjes së pacientit në departamentin e pacienteve ambulatorë ose 2) datës kur emri i një pacienti është vendosur në listen e pacientëve të shtrueshëm dhe datës së pranimit për shtrim. Koha e pritjes nuk duhet të ngatërohet me periudhën pritëse.

Waste water (Ujra mbeturina)
Nënkupton të gjitha ujrat mbeturina, pra është një koncept me i gjerë se vetëm ujrat e zeza.

Welfare economics (Ekonomi të mirëqënies). Shih "Economics" dhe "Health economics"

Willingness to pay (Gatishmëria për të paguar).
Sa i përgatitur është një person që të paguajë për mallra apo shërbime të caktuara.
Metoda e gatishmërisë për të paguar, është një metodë e vlerësimit e përdorur për të përcaktuar sasinë maksimale të parave që një individ është i gatshëm të paguajë për të marrë një përfitim të caktuar (për shembull për të marrë një shërbim të kujdesit shëndetësor). Kjo metodë përdoret shpesh për analizen kosto-përfitm për të përcaktuar në mënyrë sasiore përfitimet nga pikëpamja monetare.

Whole sale (Shitje me shumicë)
Përdoret kryesisht në shitjen e medikamenteve dhe i referohet për shembull shitjes së një medikamenti në sasira të mëdha nga një firmë

WHO(OBSH). Shkurtim në shqip për Organizata Botërore e Shëndetësisë (World Health Organization)
Është një agjensi e specializuar e Kombeve të Bashkuara me përgjegjësi parësore për çështje të shëndetit ndërkombëtar dhe shëndetit publik. Përmes kesaj organizate, e cila është krijuar në vitin 1948, mjekësia nga 191 vende të botës shkemben dijet dhe përvojën e saj me synimin për të bërë të mundur gëzimin nga të gjithë qytetarët e një shëndeti, i cili mund ti lejojë ata të bëjnë një jetë produktive nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Qendra është në Gjeneve. Shqipëria është anëtaresuar që në vitin 1947, ende pa u ratifikuar Kushtetuta e OBSH-së.

WHO Humanitarian Mission to Albania (WHO/HM). Misioni Humanitar i OBSH-së në Shqipëri)
Është një mision që u vendos në Shqiperi gjatë krizës së vitit 1997 për te mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë në kapërcimin e krizës. Që pas hapjes së zyrës, Misioni Humanitar i OBSH u perfshi ne nivele te ndryshme ndërhyrjeje si: vlerësimin e emergjencave në shendetin publik, pajisjen me

materiale emergjente, mbështetjen teknike ne sektorin farmaceutik dhe kontrollin e semundjeve infektive, rehabilitimin e laboratoreve te shëndetit publik, koordinimin dhe mbështetjen e organizmave te tjera partnere. Gjatë krizes kosovare misioni u fuqizua ndjeshëm.
Aktivitete te rendesishme te tij që vazhduan edhe pas krizes kosovare qenë në fushën e suverjancës së semundjeve infektive, kontrollin e tuberkulozit, shendetin mendor dhe farmaceutikës. Po ashtu ka pasur mbështetje të tjera si lidhur me përdorimin e duhur të gjakut, vaksinimin ndaj hepatitit B etj.
Misioni Humanitar i OBSH-së ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndesishëm në fushën e koordinimit të të gjitha agjensive të tjera të huaja që veprojnë në fushën e shendetit.

WHO Liaison Office (Zyra ndërlidhëse e OBSH-së)
Është zyra përfaqësuese e OBSH-së ne Shqipëri që drejtohet nga zyrtari ndërlidhes i OBSH-së . Funksionon që prej vitit 1992

WHO Liaison Officer (Zyrtari ndërlidhes i OBSH-së)
Nënkupton një punonjës të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili e thënë thjeshtë shërben si ndërlidhës midis OBSH-së dhe Qeverisë të vendit përkatës. Është një pozicion që vlen vetëm për vendet e Evropës Lindore dhe që u vendos për herë të parë pas ndryshimeve politike në Evropen Lindore.

Worker compensation (Kompensimi i punonjësve)
Në program sigurimi i detyrueshëm që mbulon kostot e trajtimeve mjekësore dhe të paaftësisë që lidhen me aksidentet në punë dhe sëmundjet.

World AIDS Day (Dita Botërore e AIDS-it)
Është një ditë që kujtohet çdo 1 dhjetor që prej vitit 1988, që kur në atë ditë u mblodhën ministrat e shëndetësisë nga e gjithë bota për të diskutuar mbi AIDS-n dhe ku u fol shumë për tolerancën dhe për shkëmbimin e hapur të informacionit dhe përvojës lidhur me AIDS-in.

World Bank (Banka Botërore)
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Organizatë e posaçme e Kombeve të Bashkuara e themeluar në 1945. Filloi punën në 1946. Në 1947 krijon lidhjet me
OKB-në. Qëllimi i saj është që të nxisë zhvillimin ekonomik të vendeve anëtare, duke dhënë kredi për projekte prodhuese dhe keshillim teknik. Gjithashtu ajo promovon investime private të huaja dhe tregtinë

World Health Assembly (Asambleja Botërore e Shëndetesisë)
Është organizmi suprem vendim-marrës për OBSH-në. Përgjithësisht ajo mblidhet në Gjenevë në maj të çdo viti. Në të marrin pjesë delegacione nga të gjithë 191 vendet anëtare.

World Health Day (Dita Botërore e Shëndetit)
Është një forum për informim dhe diskutim rreth shëndetit në botë. Ajo festohet çdo vit në 7 prill në 191 vende anëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Caktimi i ditës Botërore të Shëndetit ishte një nga aktet e para zyrtare të OBSH-së. 7 prilli është dita e miratimit zyrtar të kushtetutës se OBSH-së, keshtu që kjo ditë kujton pikërisht atë moment të rendesishëm të jetës së OBSH-së. Që prej vitit 1950 Dita Botërore e Shëndetësisë i kushtohet një çeshtje të caktuar specifike që përbën shqetesim botëror.

World TB Day (Dita Botërore të Tuberkulozit)
Dita Botërore e Tuberkulozit mbahet çdo vit në 24 mars. Synimi i saj është që të promovojë

ndërgjegjesimin, njohuritë dhe motivimin për të vepruar kundër tuberkulozit në mbarë botën. Ajo e ka origjinën në vitin 1882, kur u festua 100 vjetori i zbulimit të bacilit të TB-së nga Koch.

Y

Years of potential life lost (Vite të humbura potenciale të jetës)
Një masë e impaktit të vdekshmërisë të parakohëshme në një popullsi, kalkuluar si shuma e diferencave midis një minimumi të paracaktuar ose jetë të dëshiruar dhe moshës së vdekjes për individë që vdesin me herët sesa mosha e paracaktuar.

Young infant (Foshnje e re)
Femija nga një javë deri në 2 muaj

Z

Zoonosis (Zoonozë)
Një sëmundje infektive që në kushte normale është e transmetueshme nga kafshët tek njerëzit